- Depozitimin ne Regjistrin Tregtar te:
  Kontratave te shitjes se aksioneve te shoqerise "Telenorba Shqiptare" Sh.A. si me poshte:
  - nr. 1246 Rep. dhe nr. 415 Kol., date 17.11.2003;
  - nr. 1245 Rep. dhe nr. 414 Kol., date 17.11.2003;
  - nr. 1244 Rep. dhe nr. 413 Kol., date 17.11.2003;
  - nr. 1247 Rep. dhe nr. 416 Kol., date 17.11.2003;
  - nr. 1248 Rep. dhe nr. 417 Kol., date 17.11.2003;

  Deklarates se aksionareve te shoqerise Telenorba Shqiptare, Z. Giovanni D'Alessandro, Z. Eligio Romanazzi dhe Shoqerise Telenorba S.p.A., me objekt heqjen dore nga e drejta e tyre parablerjes e parashikuar ne statutin e shoqerise;
  Si dhe te akteve te tjera perkatese.

Urdherohet zyra e Regjistrit Tregtar te beje ndryshimet perkatese ne kollonen_____, germa____, si dhe te behet ndarja nga njeri tjetri me vize te kuqe.

**GJYQTARE**

*REPUBLIKA E SHQIPERISE*
*GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE*
*Nr. 23732/__*

**VENDIM I GJYQTARIT TE VETEM**
-PER DEPOZITIMIN E AKTEVE TE PERSONIT JURIDIK-

Sot me 29.12.2003, une [signature], Gjyqtare prane Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Shoqeria "Telenorba Shqiptare" Sh.A., perfaqesuar nga Znj. Azeta Tartaraj ne cilesine e Drejtorit te Shoqerise, per regjistrimin e ndryshimeve ne kollonat perkatese te Regjistrit Tregtar dhe depozitimin ne aneksin e tij te kontratave te shitjes se aksioneve, date 17.11.2003 si dhe te akteve te tjera perkatese nga te cilat:

**KONSTATOVA**

Se Shoqeria "Telenorba Shqiptare" Sh.A. eshte nje shoqeri anonime e regjistruar si person juridik ne Regjistrin Tregtar me vendimin nr. 23723 date 05.05.2000 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane. Kapitali i shoqerise, i cili eshte i barabarte me 215.000.000 Leke, siç rezulton nga vendimi nr. 23723/10 date 24.12.2002 i Gjykates se Shkalles se Pare Tirane zoterohet nga aksionaret e meposhtem:

| | |
|---|---|
| Telenorba S.p.A. | zoterues i 40% te aksioneve te shoqerise; |
| Eligio Romanazzi | zoterues i 7.5% te aksioneve te shoqerise; |
| Giovanni d'Alessandro | zoterues i 7.5% te aksioneve te shoqerise; |
| Arben Burimi | zoterues i 15% te aksioneve te shoqerise; |
| Engjell Burimi | zoterues i 15% te aksioneve te shoqerise; |
| Betim Hoxha | zoterues i 15% te aksioneve te shoqerise; |

Me date 17.11.2003 aksionaret e shoqerise Z. Arben Burimi, Z. Engjell Burimi dhe Z. Betim Hoxha, pasi aksionaret e tjere kane hequr dore nga e drejta e tyre e parablerjes mbi aksionet e shoqerise, sipas nenit 5.4 te statutit te saj, kane transferuar teresine e aksioneve te zoteruara prej tyre (qe perfaqesojne 45% te kapitalit te shoqerise) ne favor te (i) shoqerise GM net Holding S.A., shoqeri e regjistruar ne British Virgin Islands me 22.02.2002, (ii) shoqerise INFOLPUS HOLDINGS LIMITED, me seli ne adresen Themistokli Dervi n.6 Papyros Nicossia Republika e Qipros, dhe (iii) Z. Roland Makashi, shtetas shqiptar, lindur ne Kuçove, me 26.07.1966, mbajtes i pasaportes me nr. 1243494.

Pas ketij transaksioni aksionet e zoteruara nga aksionaret Z. Arben Burimi, Z. Engjell Burimi dhe Z. Betim Hoxha i transferohen aksionareve te rinj sipas ketyre perqindjeve:

- *GM net Holding S.A* blen nga Z. Engjell Burimi 10.750 aksione, qe perfaqesojne 5% te kapitalit te shoqerise dhe nga Z. Arben Burimi 32.250 aksione, qe perfaqesojne 15% te kapitalit te shoqerise. Si rrjedhim shoqeria GM net Holding S.A zoteron 43.00 aksione, qe perfaqesojne 20% te kapitalit te shoqerise;

- *INFOLPUS HOLDINGS LIMITED* blen nga Z. Engjell Burimi 10.750 aksione, qe perfaqesojne 5% te kapitalit te shoqerise dhe nga Z. Betim Hoxha 32.250 aksione, qe perfaqesojne 15% te kapitalit te shoqerise. Si rrjedhim shoqeria INFOLPUS HOLDINGS LIMITED zoteron 43.00 aksione, qe perfaqesojne 20% te kapitalit te shoqerise;
- *Z. Roland Makashi* blen nga Z. Engjell Burimi 10.750 aksione, qe perfaqesojne 5% te kapitalit te shoqerise. Si rrjedhim Z. Roland Makashi zoteron 10.750 aksione, qe perfaqesojne 5% te kapitalit te shoqerise;

**PER KETO ARSYE**

Ne baze te ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Mbi Shoqerite Tregtare" dhe te ligjit nr. 7667, date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare",

**VENDOSA**

- Pranimin e Kerkeses
- Depozitimin ne Regjistrin Tregtar te:
  Kontratave te shitjes se aksioneve te shoqerise "Telenorba Shqiptare" Sh.A. si me poshte:
  - nr. 1246 Rep. dhe nr. 415 Kol., date 17.11.2003;
  - nr. 1245 Rep. dhe nr. 414 Kol., date 17.11.2003;
  - nr. 1244 Rep. dhe nr. 413 Kol., date 17.11.2003;
  - nr. 1247 Rep. dhe nr. 416 Kol., date 17.11.2003;
  - nr. 1248 Rep. dhe nr. 417 Kol., date 17.11.2003;

  Deklarates se aksionareve te shoqerise Telenorba Shqiptare, Z. Giovanni D'Alessandro, Z. Eligio Romanazzi dhe Shoqerise Telenorba S.p.A., me objekt heqjen dore nga e drejta e tyre parablerjes e parashikuar ne statutin e shoqerise;
  Si dhe te akteve te tjera perkatese.

Urdherohet zyra e Regjistrit Tregtar te beje ndryshimet perkatese ne kollonen_____, germa____, si dhe te behet ndarja nga njeri tjetri me vize te kuqe.

**GJYQTARE**

*REPUBLIKA E SHQIPERISE*
*GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE*
*Nr. 23723/12*

**VENDIM I GJYQTARIT TE VETEM**
-PER DEPOZITIMIN E AKTEVE TE PERSONIT JURIDIK-

Sot me 21.05.2004, une Enkela Bajo, Gjyqtare prane Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Shoqeria "Telenorba Shqiptare" Sh.A., perfaqesuar nga Drejtori i Pergjithshem, i saj Z.Roland Makashi, per depozitimin ne Regjistrin Tregtar te Vendimeve te Asamblese se Aksionereve te Shoqerise "Telenorba Shqiptare" Sh.A., date 15.04.2004, Vendimit te Keshillit Mbikqyres te Shoqerise, date 15.04.2004 si dhe akteve te tjera perkatese nga te cilat:

**KONSTATOVA**

Shoqeria "Telenorba Shqiptare" Sh.A. eshte nje shoqeri anonime e regjistruar si person juridik ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me vendimin e Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane nr. 23723, date 05.05.2000.

- **Me date 15.04.2004, eshte mbajtur rregullisht Asambleja e Aksionereve te shoqerise, e cila me unanimitet ka vendosur:**

1. Te miratoje transferimin e 10% te kapitalit te shoqerise nga 55% te zoteruar perkatesisht nga aksioneret Eligio Romanazzi, Giovanni D'Alessandro dhe shoqeria "Telenorba Italia" S.p.A tek aksioneret e tjere te shoqerise, perkatesisht GM-net Holdings S.A., Infoplus Holdings Limited S.A. dhe Z. Roland Makashi nepermjet shitjes se aksioneve te tyre. Pas blerjes, aksionaret e shoqerise do te zoterojne respektivisht aksione ne shoqerine Telenorba Shqiptare SH.A. si me poshte vijon:
   - Z. Eligio ROMANAZZI do te zoteroje 6 % te kapitalit te shoqerise;
   - Z. Giovanni D'ALESSANDRO do te zoteroje 6 % te kapitalit te shoqerise;
   - Z. Roland Makashi do te zoteroje 5 % te kapitalit te shoqerise;
   - Shoqeria "Gm-Net Holdings" do te zoteroje 25 % te kapitalit te shoqerise;
   - Shoqeria "INFOPLUS" duhet te zoteroje 25 % te kapitalit te shoqerise;
   - Shoqeria " Telenorba Italia" S.p.A do te zoteroje 33 % te kapitalit te shoqerise
2. Te miratoje ndryshimet e neneve 9, 10 dhe 12 Statutit te Shoqerise si me poshte:

Ne nenin 9 shtohet paragrafi i meposhtem:

*9.7 Anetaret e Keshillit Mbikqyres emerohen nga Asambleja e Aksionereve, me propozim te aksionereve te shoqerise sipas raportit te pjesemarrjes se tyre ne kapitalin e shoqerise, dhe ne perputhje me Ligjin nr. 7638, date 19.11.1992 "per Shoqerite Tregtare".*

Ne nenin 10 shtohet paragrafi i meposhtem:

*10.5 Kryetari i Keshillit Mbikqyres zgjidhet me propozimin e nje ose me shume aksionereve te cilet perfaqesojne me shume se 50% te kapitalit te shoqerise, ndersa Zevendeskryetari i Keshillit Mbikqyres zgjidhet me propozimin e aksionereve te tjere.*

Ne nenin 12 shtohet paragrafi i meposhtem:

*12.6 Emerimi i anetareve te Bordit Drejtues do te behet ne perputhje me perfaqesimet ne Keshillin Mbikqyres.*

3. Te miratoje doreheqjen e Z. Eligio Romannazzi, Z. Giovanni D'Alessandro, Z. Engjell Burimi dhe Znj. Liliana Tare dhe te shkarkoje nga detyra e anetarit te Keshillit Mbikqyres Znj. Andia Pustina dhe Znj. Ilva Tare.
4. Te emeroje anetaret e rinj te Keshillit Mbikqyres, te cilet jane si me poshte:

- **Z. Eligio Romanazzi**, shtetas italian, lindur ne Noci, Bari, Itali, me 19 Gusht 1944, banues ne Bari, Via Amendola 172/c, mbajtes i pasaportes me nr. A 472239, ne cilesine e Zevendeskryetarit te Keshillit Mbikqyres.

- **Z. Giovanni D'Alessandro**, shtetas italian, lindur ne Conversano, Bari, Itali, me 12 Mars 1942, banues ne Conversano, mbajtes i pasaportes me nr. 598048S.

- **Z. Bernardo D'Alessandro**, shtetas italian, lindur ne Conversano, me 17 Dhjetor 1960, banues ne Conversano, mbajtes i pasaportes me nr. B 336921.

- **Znj. Irini Giara**, shtetase greke, lindur ne Athine, Greqi, me 02.04.1955 , banuese ne Ano Patisia, mbajtes i pasaportes nr. K 629599, ne cilesine e Kryetarit te Keshillit Mbikqyres.

- **Z. Theodoros Tritsarolis**, shtetas grek, lindur ne Athine, Greqi me 23.08.1964, banues ne Koridallos, Pire, mbajtes i pasaportes nr. O578644

- **Znj. Teologia Pantazoni**, shtetase greke, lindur ne Athine, Greqi, me 24.04.1960, banuese ne Kalamaki, Athine, mbajtese e pasaporte me nr. O 274317.

5. Te emeroje Eksperte Kontabel per vitin 2003 Znj. Tatjana Filto dhe Znj. Sanie Tafa.

- **Me date 15.04.2004, u mbajt rregullisht mbledhja e Keshillit Mbikqyres te Shoqerise e cila me unanimitet vendosi:**

  1. Te pranoje doreheqjen nga detyra e Drejtorit te Pergjithshem te Shoqerise te Znj. Azeta Tartaraj, duke ratifikuar dhe miratuar veprimin e saj;
  2. Te emeroje me cilesine e anetareve te Drejtorise, Z. Roland Makashi, Znj. Azeta Tartaraj, dhe Znj. Ertila Druga.
  3. Te caktoje me detyren e Drejtorit te Pergjithshem Z. Roland Makashi dhe te Zevendesdrejtorit Znj. Azeta Tartaraj.

Gjithashtu konstatova se kerkesa per depozitimin ne Regjistrin Tregtar te Vendimeve te Asamblese se Aksionereve te Shoqerise "Telenorba Shqiptare" Sh.A., date 15.04.2004, Vendimit te Keshillit Mbikqyres te Shoqerise, date 15.04.2004 dhe akteve perkatese, eshte e bazuar ne ligj, dhe:

**PER KETO ARSYE**

Ne baze te ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" dhe te ligjit nr. 7667, date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare"

**VENDOSA**

- Pranimin e Kerkeses
- Depozitimin ne Regjistrin Tregtar te:
  1. Vendimit te Asamblese se Aksionereve te Shoqerise "Telenorba Shqiptare" Sh.A., date 15.04.2004 me nr. 328 Rep. dhe nr. 144 Kol.;
  2. Vendimit te Asamblese se Aksionereve te Shoqerise "Telenorba Shqiptare" Sh.A., date 15.04.2004 me nr. 330 Rep. dhe nr. 146 Kol.;

3. Vendimit te Asamblese se Aksionereve te Shoqerise "Telenorba Shqiptare" Sh.A., date 15.04.2004 me nr. 329 Rep. dhe nr. 145 Kol.;
4. Vendimit te Keshillit Mbikqyres te Shoqerise "Telenorba Shqiptare" Sh.A., date 15.04.2004 me nr. 331 Rep. dhe nr. 147 Kol., si dhe te dokumentave perkates.

Urdherohet zyra e Regjistrit Tregtar te beje ndryshimet perkatese ne kollonen____, germa____, si dhe te behet ndarja nga njeri tjetri me vize te kuqe.

**GJYQTARE**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË**
**Nr. 23723/13 i Vendimit**

# VENDIM
# I
# GJYQTARIT TË VETËM

Sot, më datë 22/2/2007, unë Majlinda DOGGA, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi mora në shqyrtim kërkesën e bërë nga ana e kërkuesit, Z. Blendi Allushi në cilësinë e Drejtorëve, mbi depozitimin e vendimit të Asamblesë së Zakonshme të Aksionerëve të Shoqërisë Tregtare "TELENORBA SHQIPTARE" Sh.a., datë 27.11.2006 dhe të Vendimit të Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë, datë 27.11.2006,

## KONSTATOVA SE:

Shoqëria Tregtare "TELENORBA SHQIPTARE" sh.a. është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 23723, datë 05.05.2000, dhe ushtron aktivitetet e saj sipas akteve të themelimit.

Kërkuesi, Blendi Allushi me cilësinë e Drejtorit të Shoqërisë Tregtare "TELENORBA SHQIPTARE" Sh.a, kërkon depozitimin e vendimit të Asamblesë së Zakonshme të Aksionerëve datë 27.11.2006 dhe të Vendimit të Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë, datë 27.11.2006.

Me vendimin e Asamblesë së Zakonshme të Aksionerëve, të datës 27.11.2006 është vendosur emërimi i anëtarëve të rinj të Këshillit Mbikqyrës, të cilët janë Z. Eligio Romanazzi, Z. Giovanni D'Alessandro dhe nga kolektivi punonjës është zgjedhur Znj. Azeta Tartaraj.

Ndërsa me anën e Vendimit të Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë, të datës 27.11.2006 është vendosur të ndryshojë për përbërja e Drejtorisë së Shoqërisë vetëm me një Drejtor. Për këtë arsye është emëruar Drejtor i Shoqërisë Z. Blendi Allushi.

Përsa më sipër kërkesa e paraqitur për depozitimin e vendimit të Asamblesë së Zakonshme të Aksionerëve, datë 27.11.2006 dhe të Vendimit të Këshillit Mbikqyrës, datë 27.11.2006 të shoqërisë "TELENORBA SHQIPTARE" sh.a., është plotësisht e bazuar dhe si e tillë duhet pranuar.

## PËR KËTO ARSYE

Në bazë të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe të ligjit nr.7667, datë 28.01.1993 "Për Rregjistrin Tregtar",

**V E N D O S A :**

1. Pranimin e kërkesës.
2. Depozitimin e vendimit të Asamblesë së Zakonshme të Aksionerëve të Shoqërisë "TELENORBA SHQIPTARE" Sh.a., datë 27.11.2006, për emërimin e anëtarëve të rinj të Këshillit Mbikqyrës të Z. Eligio Romanazzi, Z. Giovanni D'Alessandro dhe nga kolektivi punonjës është zgjedhur Znj. Azeta Tartaraj.
3. Depozitimin e Vendimit të Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë "TELENORBA SHQIPTARE" Sh.a., datë 27.11.2006 për ndryshimin e strukturës së Drejtorisë me një Drejtor dhe emërimin si Drejtor të Z. Blendi Allushi.
4. Urdhërohet Zyra e Regjistrit Tregtar për pasqyrimin e ndryshimit në kollonën përkatëse

Kundër vendimit lejohet ankimi sipas ligjit.

**G J Y Q T A R E**

**Majlinda BOGGA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË
Nr. 23723/14 i Vendimit

# VENDIM
# I
# GJYQTARIT TË VETËM

Sot, më datë 29/03/2007, unë M. Lleshi, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi mora në shqyrtim kërkesën e bërë nga ana e kërkuesit, Z. Blendi ALLUSHI, me cilësinë e Drejtorit të shoqërisë tregtare " TELENORBA SHQIPTARE" Sh.A., mbi depozitimin e vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve, datë 27.11.2006,

## KONSTATOVA SE:

Shoqëria Tregtare " TELENORBA SHQIPTARE" Sh.A., është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 23723, datë 05.05.2000 dhe ushtron aktivitetet e saj sipas akteve të themelimit dhe legjislacionit në fuqi.

Kërkuesi, Z. Blendi ALLUSHI, Drejtor i shoqërisë tregtare " TELENORBA SHQIPTARE" Sh.A., kërkon depozitimin e vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve, datë 27.11.2006, me anën e të cilit është vendosur transferimi i aksioneve nga dy aksionerët e shoqërisë " TELENORBA SHQIPTARE" Sh.A në masën 40% të kapitalit. Aksionet do të shiten nga GM net Holding në masën 20% dhe nga Infoplus Holding Limited në masën 20% të aksioneve në kapitalin themeltar të shoqërisë. Transferimi do të bëhet në favor të aksionerit tjetër të shoqërisë, "Telenorba" spa, e cila bëhet aksioneria e shoqërisë me 80% të aksioneve në total në kapitalin e shoqërisë me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga ky zotërim.

Po kështu, konform ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" janë përpiluar para noteres Neriman MARIKA, kontratat e shit – blerjes së aksioneve të datës 19.02.2007 me nr. 2291 e nr.443 Kol. dhe nr. 2292 Rep. dhe nr. 444 Kol.

Për sa më sipër kërkesa e paraqitur, për depozitimin e vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të shoqërisë " TELENORBA SHQIPTARE" Sh.A., datë 27.11.2006, është plotësisht e bazuar dhe si e tillë duhet pranuar.

## PËR KËTO ARSYE

Në bazë të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe të ligjit nr.7667, datë 28.01.1993 "Për Rregjistrin Tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare",

**V E N D O S A :**

1. Pranimin e kërkesës.

2. Depozitimin e vendimit të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë "TELENORBA SHQIPTARE" Sh.A, datë 27.11.2006 me të cilin është vendosur:
   - Transferimi i aksioneve nga dy aksionerët e shoqërisë "TELENORBA SHQIPTARE" Sh.A, GM net Holding dhe Infoplus Holding Limited në masën 40% të kapitalit të të shoqërisë në favor të aksionerit tjetër të shoqërisë "Telenorba" spa.

3. Depozitimin e kontratave të shit – blerjes së aksioneve, përpiluar përpara noteres Neriman Marika të datës 19.02.2007 me nr. 2291 e nr.443 Kol. dhe nr. 2292 Rep. dhe nr. 444 Kol.

4. Urdhërohet Zyra e Regjistrit Tregtar të pasqyrojë ndryshimet e mësipërme në kollonat përkatëse.

Kundër vendimit lejohet ankimi sipas ligjit.

GJYQTARE

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË**
**Nr. 23723/15 i Vendimit**

**VENDIM**
**I**
**GJYQTARIT TË VETËM**

Sot, më datë 3 / 7 /2007, unë M Dogja, Gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi mora në shqyrtim kërkesën e bërë nga ana e kërkuesit, Z. Redi SATA, me cilësinë e Drejtorit të Shoqërisë Tregtare "TELENORBA SHQIPTARE" Sh.a., mbi depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve, Vendimit të Asamblesë së Zakonshme të Aksionerëve dhe të Vendimit të Këshillit Mbikqyrës, të datës 31.03.2007,

**KONSTATOVA SE:**

Shoqëria Tregtare "TELENORBA SHQIPTARE" Sh.a. është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 23723. datë 05.05.2000 dhe ushtron aktivitetin e saj sipas akteve të themelimit dhe legjislacionit në fuqi.

Kërkuesi Z. Redi SATA, Drejtor i Shoqërisë "TELENORBA SHQIPTARE" Sh.a., kërkon depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të Shoqërisë, datë 31.03.2007 me anën e të cilit është vendosur për transferimin e aksioneve të shoqërisë në masën 85% kapitalit themeltar. Aksionet janë shitur në masën 80% nga aksioneri Telenorba Spa dhe në masën 5% nga aksioneri Z. Roland Makashi, të cilët sipas këtij operacioni kanë humbur pronësinë mbi aksionet e shitura dhe njëkohësisht cilësinë e aksionerëve. Aksionet janë blerë në masën 80% nga Z. Redi Sata, i cili fiton pronësinë me të gjithë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga transferimi si dhe cilësinë e aksionerit të shoqërisë "TELENORBA SHQIPTARE" Sh.a. Ndërsa pjesa prej 5% të aksioneve blihet nga aksioneri i shoqërisë Z. Giovanni D'Alessandro. Për këtë qëllim palët kanë lidhur kontratat noteriale të shit-blerjes së aksioneve nr. 2346 Rep / nr. 462 Kol dhe nr. 2347 Rep / nr. 463 Kol, të datës 31.03 .2007 para noteres Neriman Marika. Pas këtij operacioni shit-blerje aksionesh, kapitali i shoqërisë "TELENORBA SHQIPTARE" Sh.a. do të zotërohet në këtë mënyrë:

1. Z. Eligio Romanazzi, në cilësinë e aksionerit zotëron 7.5% të kapitalit të shoqërisë;
2. Z. Giovani D'Alessandro, në cilësinë e aksionerit, zotëron 12.5% të kapitalit të shoqërisë;
3. Z. Redi Sata, në cilësinë e aksionerit, zotëron 80% të kapitalit të shoqërisë.

Gjithashtu Z. Sata në cilësinë e Drejtorit, ka kërkuar depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Zakonshme të Shoqërisë "TELENORBA SHQIPTARE" Sh.a., datë

4. [illegible] i [illegible] Elipas [illegible]

[illegible] i [illegible] në [illegible]

19. 4. 2002

5. 5. 2002

[illegible]

[illegible] kandidat
+ [illegible] Clopet.
[illegible]

# AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ANONIME PA OFERTË PUBLIKE "TELENORBA SHQIPTARE" SH.A.

*Sot më datë 19 prill 2000, të nënshkruarit*

1. Z. Eligio ROMANAZZI, qytetar italian, lindur në Noci (BA), Itali, më 19 gusht 1944 dhe rezident në Bari, Via Amendola 172/c, Pasaportë nr.141482B (me adresë në Shqipëri: Rruga Ismail Qemali, 27, Tirana);

2. Z. Donato D'ALESSANDRO, qytetar italian, lindur në Bari (BA), Itali, më 27 qershor 1961, dhe banues në Conversano (BA), Itali, me Pas. nr. 598874S (me adresë në Shqipëri: Rruga Ismail Qemali, 27, Tirana).

3. Z. Giovanni D'ALESSANDRO, qytetar italian, lindur në Conversano (BA), Itali, më 12 mars 1942, dhe banues në Conversano (BA) Itali, me Pas. nr. 598048S (me adresë në Shqipëri: Rruga Ismail Qemali, 27, Tirana).

4. Shoqëria "Scorpion" Sh.p.k., me seli në Tiranë, regjistruar pranë Gjykatës së Tiranës me vendimin nr. 23590, datë 11 prill 2000, e përfaqësuar ligjërisht nga administratorja e saj, Znj. Andria PUSTINA, e autorizuar ligjërisht të marrë pjesë si ortak themelues në formimin e Shoqërisë në bazë të vendimit të ortakëve të lëshuar më 19 prill 2000, që bashkangjitet si (Shtojca 5).

(më poshtë referuar si "Ortakët Themelues")

në bazë të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992, "Për Shoqëritë Tregtare" kanë rënë dakord të themelojnë një shoqëri të quajtur "TELENORBA SHQIPTARE" Sh.A. (më poshtë referuar si "Shoqëria") duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i Shoqërisë rregullohet nga Statuti, nga ky Akt Themelimi të cilat janë pranuar tërësisht dhe nënshkruar nga Ortakët Themelues.

## Neni 1

1.1. Është krijuar Shoqëria "TELENORBA SHQIPTARE" Sh.A. në formën e shoqërisë anonime pa ofertë publike, me seli në Tiranë, Rruga Ismail Qemali, 27.

1.2. Kohëzgjatja e aktivitetit është 50 (pesëdhjetë) vjet.

## Neni 2

2.1. Objekti i Shoqërisë është aktiviteti radiotelevizivi privat. Ajo përfshin prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve të çdo lloji me anë të zërit, figurës, sinjaleve të koduara, shkrimit, të destinuara për publikun nëpërmjet valëve elektromagnetike, kabllove, përsëritësve, satelitëve apo me çdo mjet tjetër, duke respektuar paanshmërisht të drejtën për informacion, bindjet politike e besimet fetare, personalitetin, dinjitetin, jetën private të njeriut, si dhe të drejtat dhe liritë themelore të tij.

2.2. Shoqëria mund të financohet nëpërmjet reklamës dhe sponsorizimeve në përputhje me sa parashikon legjislacioni në fuqi.

2.3. Aktiviteti i Shoqërisë do të zhvillohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe në mënyrë të veçantë me ligjin nr. 7638, të datës 19 nëntor 1992, *"Për Shoqëritë Tregtare"* siç është ndryshuar, dhe ligjin nr. 8410, i datës 30 shtator 1998 *"Për radion dhe televizionin publik në Republikën e Shqipërisë"*.

2.4. Sipas legjislacionit në fuqi dhe për arritjen e objektit të Shoqërisë dhe të qëllimeve të saj, Shoqëria mund:

- të kryejë të gjitha veprimet në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë që lidhen me qëllimin e sipërpërmendur si edhe për administrimin e Shoqërisë, përfshirë aktivitete industriale, tregtare dhe shitblerjeje pasurie të paluajtshme dhe të marrë edhe interesa jo aksionere, në Shoqëri, agjensi, ente dhe ndërmarrje, të cilat mund të kenë edhe qëllime të tjera por që funksionalisht lidhen me aktivitetin televiziv;

- jep garanci, mund të hipotekojë në favor të ndonjë banke, instituti krediti ose financiar.

2.5. Shoqëria mund të kryejë shërbimet e sipërpërmendura si drejtëpërsëdrejti ashtu edhe nëpërmjet konsulentëve ose të tretëve.

2.6. Shoqëria mund të marrë pjesë në tendera dhe të kërkojë financime në Shqipëri dhe jashtë vendit.

**Neni 3**

3.1. Kapitalit themeltar i Shoqërisë është caktuar në 70.000.000 (shtatëdhjetë milion) lekë i ndarë në 70.000 (shtatedhjete mije) aksione nominative dhe të regjistruara me një vlerë nominale prej 1.000 (njëmijë) lek secila.

3.2. Kapitali i Shoqërisë formohet nga kontributet mëposhtme në para dhe në natyrë të Ortakëve Themelues:

1. Z. Eligio ROMANAZZI, ka nënshkruar 10.040 (dhjetëmijë e dyzet) aksione, që u korrespondojnë 14,35 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë, nëpërmjet:

   a. kalimit të së drejtës së pronësisë së pajisjeve, siç është përcaktuar më saktë në inventarin që i bashkëngjitet raportit të ekspertit Naxhip ÇEÇI, i përgatitur më 3 prill 2000 (Shtojca 1) Në bazë të nenit 91 të ligjit 7638, datë 19 nëntor 1992 *"Për Shoqëritë Tregtare"*, vlera e kontributit të së drejtës së pronësisë është vlerësuar në shumën prej 4.900.000 (katër milion e nëntëqindmijë) lekë;

   b. depozitimin në para të shumës të barabartë me 5.140.000 (pesë milion e njëqind e dyzetmijë) nëpërmjet depozitimit të 25 % të kësaj shume të barabartë me 1.285.000 (një milion e dyqind e tetëdhjetëepesëmijë) në llogarinë rrjedhëse nr. 16132, të hapur pranë Bankës Italo-Shqiptare, selia Tiranë, në favor të Shoqërisë në krijim e sipër "TELENORBA SHQIPTARE" Sh.A. (Shtojca 6)

2. Shoqëria "SCORPION" Sh.p.k. ka nënshkruar 16.560 (gjashtëmbëdhjetëmijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) aksione, që i korrespondojnë23,65 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë, nëpërmjet kalimit të së drejtës së pronësisë të një apartamenti me një sipërfaqe të përgjithshme prej 130 (njëqind e tridhjetë) m2, të ndodhur në Tiranë, siç është përcaktuar më saktë në letrën e transkriptimit të Zyrës së Hipotekës së Tiranës nr. 1818 të 29 prill 1998 bashkëngjitur raportit të ekspertit Z. Bujar BASHA, të përgatitur më 20 mars 2000 (Shtojca 2). Në bazë të nenit 91 të ligjit 7638, datë 19 nëntor 1992 "*Për Shoqëritë Tregtare*", vlera e kontributit të së drejtës së pronësisë është vlerësuar në një shumë të përgjithshme prej 16.560.000 (gjashtëmbëdhjetë milion e pesëqind e gjashtëdhjetëmijë) lekë;

3. Z. Donato D'ALESSANDRO, ka nënshkruar 28.000 (njëzet e tetëmijë) aksione, që u korrespondojnë 40 % të kapitalit të Shoqërisë, nëpërmjet kalimit të së drejtës së pronësisë së pajisjeve, siç është përcaktuar më saktë në inventarin që i bashkëngjitet raportit të ekspertit Naxhip ÇEÇI, i përgatitur më 3 prill 2000 (Shtojca 3). Në bazë të nenit 91 të ligjit 7638, datë 19 nëntor 1992 "*Për Shoqëritë Tregtare*", vlera e kontributit të së drejtës së pronësisë është vlerësuar në një shumë të përgjithshme prej 28.000.000 (njëzet e tetë milion) lekë;

4. Z. Giovanni D'ALESSANDRO, ka nënshkruar 15.400 (pesëmbëdhjetë e katërqind) aksione, që u korrespondojnë 22 % të kapitalit të Shoqërisë, nëpërmjet kalimit të së drejtës së pronësisë së pajisjeve, siç është përcaktuar më saktë në inventarin që i bashkëngjitet raportit të ekspertit Nexhip ÇEÇI, i përgatitur më 3 prill 2000 (Shtojca 4). Në bazë të nenit 91 të ligjit 7638, datë 19 nëntor 1992 "*Për Shoqëritë Tregtare*", vlera e kontributit të së drejtës së pronësisë është vlerësuar në një shumë të përgjithshme prej 15.400.000 (pesëmbëdhjetë milion e katërqindmijë) lekë;

3.2. Pjesa e kapitalit të Shoqërisë që mbetet për t'u depozituar në para do të paguhet në përputhje me atë që do të përcaktohet me vendim të Drejtorit.

**Neni 4**

4.1. Për dy vjetët e parë Shoqëria do të administrohet nga një Drejtori, përbërja e së cilës do të vendoset nga Këshilli Mbikqyrës i Shoqërisë. Këshilli Mbikqyrës mund të vendosë emërimin e një Drejtori të Përgjithsëm në vend të një Drejtorie.

4.2. Drejtori i Përgjithshëm ose anëtarët e Drejtorisë do të qëndrojnë në detyrë për 2 (dy) vjet.

4.3. Kompetencat e Drejtorit të Përgjithëm ose të Drejtorisë janë përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

## Neni 5

5.1. Këshilli Mbikqyrës i Shoqërisë është i përbërë nga 3 (tre) anëtarë.

5.2. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë qëndrojnë në këtë detyrë për 3 (tre) vjet.

5.3. Kompetencat e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës janë përcaktuar nga ligji dhe nga Statuti i Shoqërisë.

5.4. Në bazë të neneve 93 dhe 105 të ligjit nr. 7638, datë 19 nëntor 1992, "*Për Shoqëritë tregtare*" dhe me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme,. Anëtarët e parë të Këshillit Mbikqyrës janë:

1. Kryetari i Këshillit Mbikqyrës
Z. Donato D'ALESSANDRO, qytetar italian, lindur në Bari (BA), Itali, më 27 qershor 1961, dhe banues në Conversano (BA), Itali, me Pas. nr. 598874S (me adresë në Shqipëri: Rruga Ismail Qemali, 27, Tirana).

2. Zëvendës Kryetari i Këshillit Mbikqyrës
Z. Giovanni D'ALESSANDRO, qytetar italian, lindur në Conversano (BA), Itali, më 12 mars 1942, dhe banues në Conversano (BA) Itali, me Pas. nr. 598048S (me adresë në Shqipëri: Rruga Ismail Qemali, 27, Tirana).

3. Anëtar i Këshillit Mbikqyrës
Znj. Andia PUSTINA, qytetare shqiptare, lindur në Tiranë, më 20 janar 1971, dhe banuese në Tiranë Rruga Don Bosco, Pall. Al_Mak, B-4, Ap. 29, me Pas. nr. 0815749.

## Neni 6

Viti i parë financiar do të fillojë me regjistrimin e Shoqërisë pranë autoriteteve kompetente shqiptare dhe do të përfundojë në 31 dhjetor të të njëjtit vit.

## Neni 7

Ortakët Themelues emërojnë me këtë akt ortakun themelues:

Z. Eligio ROMANAZZI, me qëllim që të merret me regjistrimin e shoqërisë pranë autoriteteve kompetente administrative, fiskale dhe të sigurimeve shoqërore shqiptare dhe të kryejë të gjitha proçedurat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për të lejuar Shoqërinë të realizojë qëllimin e saj. Ai do të ketë gjithashtu edhe kompetencën për ti deleguar personave të tretë përmbushjen e veprimeve të veçanta.

## Neni 8

8.1. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga interpretimi, zbatimi dhe zgjidhja e këtij Akti Themelimi, si edhe mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve të ardhshëm të mundshëm (përveç atyre që lindin nga raporte personale apo jashtë Shoqërisë) ose mosmarrëveshjet midis një apo më shumë ortakëve dhe

Shoqërisë, do të shtrohen për zgjidhje miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë midis të interesuarve.

8.2. Në rast se mosmarrëveshja nuk arrihet të zgjidhet me mirkuptim, zgjidhja e saj do t'i besohet një gjykate kompetente shqiptare, me kusht që ortakët italianë të kenë të drejtë të kërkojnë në mënyrë alternative shtrimin e çështjes për zgjidhje prej një kolegji arbitrash. Procedura arbitrale do të bëhet në përputhje me dispozitat e parashikuara në Statut.

**Neni 9**

Ky Akt Themelimi është hartuar në katër kopje në gjuhën italiane duke i bashkëngjitur edhe kopjen në shqip. Të gjitha mosmarrëveshjet në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Akti, versioni italisht do të jetë i vetmi version i detyrueshëm.

* * * *

Tiranë 19 prill 2000

Ortakët Themelues:

Z. Eligio ROMANAZZI

Z. Donato D'ALESSANDRO

Për Shoqërinë SCORPION Sh.p.k
Znj. Andia PUSTINA

Z. Giovanni D'ALESSANDRO

PULLE TAKSE

# AKT THEMELIMI

# I

# SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

# "SCORPION" SH.P.K

REPUBLIKA SHQIPERISE
Dhoma Notereve TIRANE
Nr 1417 Dt 18.04.2000
VERTETOHET FOTOKOPJA
NJE ME ORIGJINALIN

NOTERE
GJYLTERE PUSTINA

Neni 1

Krijohet Shoqeria Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuara(sh.p.k)
**Shoqeria do te quhet "SCORPION" SH.P.K**
Kjo shoqeri do te kete seline e saj ne Tirane, Rruga Ismail Qemali, pallati I Fratarit, ap. No. 29.,dhe do kete nje kohezgjatje prej 10 vjetesh,periudhe qe mund te zgjatet me nje marreveshje unanime ndermjet ortakeve,ne baze te ligjit shqipetar.
Shoqeria mund te kete seli dytesore,filiale,ne Shqiperi ose dhe jashte saj.

Neni 2

Sipas legjislacionit shqiptar,shoqeria eshte person juridik shqiptar dhe zhvillon aktivitetin e saj ne baze te kontrates ekzistuese,bashkangjitur statutit dhe dispozitave te legjislacionit shqiptar.

Neni 3

Selia e Shoqerise Tregtare " SCORPION Sh.p.k. eshte aktualisht ne Tirane Rruga " Ismail Qemali, Pallati I Fratarit., Ap. 29.
Asambleja e shoqerise ( Ortaku i Vetem ) ka te drejte te hapi ose te mbylli filialet,deget, pa kufizime territoriale.

Neni 4

Objekti I shoqerise se perbere do te jete si me poshte:

Objekti Social i Shoqerise do te jete ushtrimi per llogari te veten dhe per te tretet, ne Shqiperi dhe jashte, i prodhimit te software- ve per tregun: i sherbimeve te konsulences dhe organizimit, perfshire kerkimet, perzgjedhjen dhe formimin e personelit; te sherbimeve te konsulences tekniko-ekonomike, studimeve dhe planifikimeve, projektimeve, asistence per blerje dhe tendera; te sherbimeve te kompjuterizuara, asistence per kursimin e energjise dhe

per prezantimin e vektoreve (transportuesve) te rinj energjitike; te sherbimeve te informatikes, software, nxjerrje dhe perpunim te dhenash dhe te mundesive teknike te integruara te projektit, drejtim punimesh, matje dhe kontabilitet, te punimeve te brendeshme, operacione tregtare, financiare, pasurish te paluajtshme, indusriale, ndertimore, elektroteknike, telekomunikacioni televizive, ne pergjithesi, hidraulike, rrugore, inxhenieriko- shendetesore dhe mirembajte e perkujdesje te territorit dhe mjedisit.

Neni 5

Per realizimin e objektivave te shoqerise,palet bien dakorte te bashkojne kapitalin e tyre per permiresimin e organizimit dhe zhvillimin e aktivitetit te saj.
Kapitali eshte caktuar ne Lek 16.560.000, dhe mund te shtohet sipas vendimit te Asamblese se shoqerise (ortakut te vetem), si dhe ne baze te normave ne fuqi, dhe te ndahet ne kuota sipas librit te orakeve te barabarta nga 1.000 lek per kuote. Kapitali eshte ne natyre I perbere nga nje apartament, nje garazh nentokesor dhe vend parkimi te hapur te vleresuara keto nga Ing. Bujar Basha, ekspert per vleresimet , I pajisur me license Nr. 0442/2 te leshuar nga Ministria e Puneve Publike dhe transporteve dhe rregjistruar ne Rregjistrin Tregtar te Gjykates se Rrethit Tirane me vendimin Nr 786, date 29.01.1994. Apartamenti perbehet nga tre dhoma dy nga te cilat me ballkone te orientuara nga Jug-Perendimi, nje banje +VC, nje sallon I gjere qe lidhet me deren e hyrjes se apartamentit me nje korridor. Siperfaqja e gjithe apartamentit eshte 130 m2 dhe lartesi H=2.9m. Garazhi me nr .16 I cili e ka siperfaqen 18 m2 si dhe vend parkimi I hapur me sip. 8m2.

Neni 6

Kapitali I shoqerise mund te varioje sipas nevojave te shoqerise ne marreveshje midis paleve.
Kapitali I shoqerise I nenshkruar respektivisht do te regjistrohet ne llogarite e shoqerise dhe do perpilohet nje certifikate per cdo kuote te derdhur.

Neni 7

Shoqeria e fillon aktivitetin e saj ne momentin e autorizimit nga organet kopetente shqiptare.
Fitimi qe shoqeria do te realizoj nga nxjerrjet e shpenzimeve dhe pagimi I taksave ligjore do te taksohet sipas dispozitave te Ministrise se Financave te Republikes se Shqiperise ne perputhje me legjislacionin shqipetar.
Fitimi I mbetur do te ndahet ndermjete ortakeve sipas parashikmit ne nenin 5 te kesaj kontrate.

Neni 8

Shoqeria do te administrohet nga nje keshill administrativ ose nga nje Administrator I Vetem qe do te emerohet nga mbledhja e Asamblese se ortakeve.
Ne mbjedhjen e themelimit te Shoqerise Ortaku I vetem emeron si Administrator te vetem te Shoqerise Zn. Andia Pustina.

Neni 9

Ortaket ja te detyruar te ruajne karakterin sekret te dokumentacionit,te Know-how dhe te eksperiencav te shkembimit realizuar brenda aktivitetit te shoqerise,duke evituar gjithashtu edhe shperndarjen e pjeseshme.
Ortaket jane pergjegjes per rrjedhimet e demshme te shkeljes se detyrimeve,kur keton shkelje jane rezultat I akteve te vendosura ose te neglizhences.

Neni 10

Te gjitha mosmarreveshjet mund te zgjidhen me mirekuptim, ne te kundert do te zgjidhen prane Gjykates se Rrethit Tirane.

Neni 11

Nenet e detajuar qe rregullojne funksionimin e shoqerise, jane percaktuar ne statutin qe I bashkangjitet kesaj kontrate.

Neni 12

Ky akt u perpilua ne kater kopje origjinale ne gjuhen shqipe dhe ne gjuhen italiane.per t'iu shperndare organeve si me poshte:

- Gjykaten e rrethit te Tiranes per te bere veprimet ne Regjistrin Tregtar dhe njohjen si person juridik te kesa Shoqerie
- Zyren e Tatimeve per marrjen e lejes se ushtrimit te veprimtarise
- Dhomen e Noterise
- nje kopje mbetet si pjese e dokumentacionit te themelimit te shoqerise

TIRANE 7-4- 2000

**ORTAK I VETEM**

I SHOQERISE TREGTARE "SCORPION "

ELIGIO ROMANAZZI

# STATUTI I SHOQERISE

# TREGTARE

## "SCORPION Sh.p.k"

REPUBLIKA SHQIPTARE
Dhoma Notereve TIRANE
N. 142 D. 12-04-199
VERTETOHET FOTOKOPJA
NJEJTE ME ORIGJINALIN

NOTERE
GJYQTARE POSTINA

## KAPITULLI 1

## EMERTIMI- OBJEKTI –SELIA-KOHEZGJATJA

Neni 1

Themelohet Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar nen emertimin "SCORPION Sh.p.k"
Shoqeria eshte Persone Juridik Shqiptar themeluar ne baze te dekretit te ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligjit Nr.7540, date 04.08.1992 "Per investimet e huaja".
Shoqeria gezon te drejten e personit juridik shqiptar duke filluar nga data qe organet kopetente shqiptare kane dhene aprovimin per krijimin e saj.

Neni 2

Shoqeria e zhvillon aktivitetin e saj konform ligjeve te legjislacionit shqiptar dhe dispozitave te parashikuara ne dokumentat per themelimin e saj.

Neni 3

Objekti Social i Shoqerise do te jete ushtrimi per llogari te veten dhe per te tretet, ne Shqiperi dhe jashte, i prodhimit te software- ve per tregun: i sherbimeve te konsulences dhe organizimit, perfshire kerkimet, perzgjedhjen dhe formimin e personelit; te sherbimeve te konsulences tekniko-ekonomike, studimeve dhe planifikimeve, projektimeve, asistence per blerje dhe tendera; te sherbimeve te kompjuterizuara, asistence per kursimin e energjise dhe per prezantimin e vektoreve (transportuesve) te rinj energjitike; te sherbimeve te informatikes, software, nxjerrje dhe perpunim te dhenash dhe te mundesive teknike te integruara te projektit, drejtim punimesh, matje dhe kontabilitet, te punimeve te brendeshme, operacione tregtare, financiare, pasurish te paluajtshme, indusriale, ndertimore, elektroteknike, telekomunikacioni televizive, ne pergjithesi, hidraulike, rrugore, inxhenieriko- shendetesore dhe mirembajte e perkujdesje te territorit dhe mjedisit.

Neni 4

Selia e Shoqerise Tregtare " SCORPION Sh.p.k. eshte aktualisht ne Tirane Rruga " Ismail Qemali, Pallati I Fratarit., Ap. 29.
Asambleja e shoqerise ( Ortaku i Vetem ) ka te drejte te hapi ose te mbylli filialet,deget, pa kufizime territoriale.

Neni 5

Shoqeria nuk ka pergjegjesi per detyrimet qe nuk kane te bejne me aktivitetin e saj industrial, ekonomik dhe tregtare qe ortaket zhvillojne ne menyre te pavarur.
Shoqeria pergjigjet eskluzivisht me te mirat perkatese.

Neni 6

Vendbanimi I ortakeve, per sa I perket mardhenieve te tyre me shoqerine, ne baze te efekteve te ligjit, eshte ajo qe shkruhet ne librin e ortakeve.

Neni 7

Kohezgjatja e shoqerise eshte per 10 vjet te njepasnjeshem por mund te shkrihet ose te shtyhet nje ose me shume here sipas vendimit te asamblese ( ortakut te vet)

KAPITULLI 2

KAPITALI

Neni 8

Kapitali eshte caktuar ne Lek 16.560.000, dhe mund te shtohet sipas vendimit te Asamblese se shoqerise (ortakut te vetem), si dhe ne baze te normave ne fuqi, dhe te ndahet ne kuota sipas librit te orakeve te barabarta nga 1.000 lek per kuote. Kapitali eshte ne natyre I perbere nga nje apartament, nje garazh nentokesor dhe vend parkimi te hapur te vleresuara keto nga Ing. Bujar Basha, ekspert per vleresimet , I pajisur me license Nr. 0442/2 te leshuar nga Ministria e Puneve Publike dhe transporteve dhe rregjistruar ne Rregjistrin Tregtar te Gjykates se Rrethit Tirane me vendimin Nr 786, date 29.01.1994. Apartamenti perbehet nga tre dhoma dy nga te cilat me ballkone te orientuara nga Jug-Perendimi, nje banje +WC, nje sallon I gjere qe lidhet me deren e hyrjes se apartamentit me nje korridor. Siperfaqja e gjithe apartamentit eshte 130 m2 dhe lartesi H=2.9m. Garazhi me nr .16 I cili e ka siperfaqen 18 m2 si dhe vend parkimi I hapur me sip. 8m2.

Per te realizuar objektivat e shoqerise, Ortaket ( ortaku I vetem) mund te vendosin per rritjen e zmadhimin e Kapitalit te Shoqerise bazuar ne legjislacion shqiptar.

Neni 10

Shoqeria do te paise cdo ortak me nje certifikate ku verteteton cilesine e tij si ortake dhe depozitimin e kuotave te poseduara nga ai.

Neni 11

Ne rastin e transformit te Shoqerise ne Shoqeri me shume ortakeri, te drejtat e bashkepronareve, per kuoten e pronesise te perbashket te me shume se nje personi, duhet te jene te ushtruara nga nje perfaqesues I perbashket.

Neni 12

Ortaket, me kerkese te thjeshte drejtuar Keshillit Administrativ te shoqerise, me kusht qe bashkarisht dhe ne proporcione te kuotave te poseduara, mund te vendosin ne dispoziocin te shoqerise te tjera fonde ose mjete finanziare ne llogari te kapitalit per te lejuar me mire arritjet e objektit te shoqerise.
Asamblea mund te vendosi here pas here kushtet e kthimit te shumave te dhena.

Neni 13

Kuotat e kapitalit te shoqerise jane lehtesishte te transferueshme ndermjete ortakeve.

Neni 14

Ortakeve ju eshte rezervuar e drejta e parablerjes ne kuotat ose pjeset te kuotave te leshuara nga ortaket.
E drejta e parablerjes duhet te jete ne kufijte e tridhjete diteve nga data e komunikimit te kerkeses te leshimit se kuotes vetjake ose pjese prej
saj, e zbatuar me leter te rekomanduar nga secili prej ortakeve dhe nga shoqeria vete.

Neni 15

Kuotat jane lehtesishte te transferueshme ne rast trashegimie ose ne rastin e shkrirjes se lidhjes ndermjete bashkeshorteve, paraardheseve ose pasardheseve.

Neni16

Duke perjashtuar te drejten per parablerjen e kuotave, rezervuar ortakeve, kuotat e kapitalit te shoqerise mund tu transferohen te treteve qe nuk bejne pjese ne shoqeri me modalitet e parashikuara nga neni 47 te ligjit 7638/92.

Neni17

Transferimi I kuotave duhet te kryhet me akt noterial.
Transferimi nuk eshte I kundershtueshem nga shoqeria ose nga te tretet ne rast se me pas I njoftohet shoqerise.

Neni 18

Derdhjet e kuotave ne shoqeri jane te kerkuara nga Keshilli Administrativ ne kufijte dhe menyrat qe vete shoqeria do ti quaj te arsyeshme, duke vendosur per ndryshimet eventuale dhe sanksionet per vonesat.

## KAPITULLI 3

Shoqeria Tregtare "SCORPION Sh.p.k"eshte prone e ortakut te vetem Z. Eligio Romanazzi dhe drejtohet nga Administratori I Vetem I saje Zn Andia Pustina. Ortaku I Vetem gezon te gjitha atributet e Asamblese se Shoqerise, ndersa administratori I Vetem I Shoqerise gezon te gjitha te drejtat per drejtimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te Shoqerise.

Ne se Shoqeria do te shnderrohet ne nje Shoqeri me me shume se nje ortak atehe dispozitat si me poshte do te jene ne fuqi.

## ASAMBLEA

Neni19

Asamblea e formuar regullisht perfaqeson unanimitetin e ortakeve dhe vendimeve, te marra konform ligjit dhe statutit.

Neni 20

Asamblea e ortakeve mund te thiret ne seline e shoqerise ose ne vendin e vendosur ne lajmerimin e mbledhjes.

Neni 21

Keshilli administrativ eshte I detyruar te therase Asamblene e ortakeve, dhe ndonjehere shumicen e ortakeve, qe perfaqesojne te pakten nje te dhjeten e kapitalit te shoqerise, te bejne kerkesen me leter te rekomanduar ku te tregojne argumentet qe do te trajtohen.

Neni 22

Cdo ortake gezon te drejten e nje vote per cdo njemije lek te kuotes.
Ne rast se kuota eshte shumefishi shifrave te tilla, ortake ka te drejte te e nje vote per cdo njemije lek.

Neni 23

Mbledhjet e Asamblese duhet te kryhen nen kujdesin e Keshillit Administrativ njoftuar me leter te rekomanduar paraqitur nga ortaket te pakten pesembedhjete dite para mbledhjes.
Ne leter duhet te jene treguar vendi, dita ora e mbledjes dhe si dhe problemet e vendosura ne rendin e dites.
Ekspertetet kontabel te autorizuar dhe te emeruar,duhet te jene te lajmeruar per mbeldhjen e asamblese se ortakeve si me siper, duke mos ndaluar te drejten e tyre per te marre pjese ne kete asamble.
Asamblea eshte e vlefshme nese bazohet ne nenin 57 te ligjit 7638/92, dhe ne mungese te formaliteteve te nenit te meparshem,ne rast se eshte prezent ose I perfaqesuar kapitali I plote I shoqerise.

Neni 24

Cdo ortake gezon te drejten e pjesemarrjes ne Asamble ose te perfaqsohet nga nje I trete jo ortake. Perfaqesimi, mund jepet vetem per nje mbledhje asambleje, ose me efekt edhe per mbledhjet e mepasme, duhet te jepet me shkrim dhe dokumentat duhet te ruhen nga shoqeria.

Neni 25

E drejta e per te marre pjese ne asamble te ortakeve qe kane deleguar te trete, duhet te konstatohet dhe te njihet nga vete presidenti I asamblese.

Neni 26

Autorizimi per te marre pjese ne asamblene e ortakeve nuk mund te jepet pa percaktuar emerin e perfaqesuesit .
Perfaqesuesi mund te zevendesohet vetem nga persona shprehimisht dhe paraprakisht te treguar ne autorizim.

Neni 27

Asamblea drejtohet nga presidenti I Keshillit Administrativ.Ne te kundert. Asamblea zgjedh presidentin.

Neni 28

Presidenti eshte I shoqeruar nga nje sekretar I cili mund te mos jete ortak,me vendim te presidentit,nga dy vezhgues zgjedhur ndermjet orakeve.

Neni 29

Vendimet e asamblese duhet te rezultojne te firmosura nga dhe nga sekretari.Kur Ligji e kerkon ne menyre specifike apo Keshilli Administrativ e shikon te arsyeshme, procesverbali duhet te redaktohet nga nje noter.

Neni 30

Vendimet e asamblese duhet te merren me votim te hapur,ndersa emerimet e funksioneve ne shoqeri duhet te merren me votim te hapur ose me votim te fshehte.

Neni 31

Asamblea e orakeve vendos regullisht me votim te ortakeve qe perfaqesojne me shume se gjysmen e kapitalit te shoqerise.
Edhe ne qofte se ortaket mblidhen ne nje mbledhje te dyte, vendimet merren me votim te ortakeve qe perfaqesojne te pakten gjysmen e kapitalit te shoqerise.

Neni 32

Ne rast ndryshimi te statutit dhe te kontrates,asamblea vendos regullisht, ne mbledhjen e pare dhe te dyte, me votim te otakeve qe perfaqesojne te pakten ¾ e kapitalit te shoqerise.

## KAPITULLI 4

## ADMINISTRIMI

Neni 33

Shoqeria administrohet, sipas persa vendos asamblea,me votim te ortakeve qe perfaqesojne me shume se gjysmen e kapitalit te shoqerise, nga nje Administrator I Vetem ose nga keshilli administrativ I perber nda dy deri pese anetar,te cilet mund te mos jene ortake,te zgjedhur nga asamblea me afat te pacaktuar ose per nje periudhe qe asamblea cakton ne aktin e emerimit.

Neni 34

Keshilli administrativ zgjedh ne te njejten menyre presidentin dhe zv/presidentin qe e zevendeson ate ne rast mosparaqitje ose ndalimi.

Neni 35

Ne rast mungese te shumices se administratoreve,duhet te shperndahet I gjithe keshilli dhe,me pas,duhet te mblidhet pa vonese asamblea per emerimin e te gjithe administratoreve.

Neni 36

Keshilli administrativ mblidhet si prane selise se shoqerise,si dhe kudo ku presidenti e sheh te nevojshme.

Neni 37

Keshilli administrativ mblidhet nga presidenti me komunikim me shkrim,te pakten shtate dite para mbledhes,cdo administratori.

Neni 38

Keshilli administrativ,ne rast gabimi te formaliteteve te nenit 35, vendos vlefshmerisht me pjesmarrjen e te gjithe administratoreve.

Neni 39

Vendimet e keshillit administrativ jane te vlefshme kur merren me shumicen e votave dhe me pjesmarrjen e shumices se anetareve te tij ne detyre.

Neni 40

Nje anetar I keshillit administrativ mund te perfaqesohet me autorizim te shkruar.

Neni 41

Anetareve te keshillit administrativ ju perket nje rroge vjetore fikse nga asamblea e ortakeve,gjithashtu rimbursimi I shpenzimeve te bera per arsye te detyres se tyre.

Neni 42

Asamblea e ortakeve ka te drejte ti caktoj keshillit administrativ,me vendimin perkates,nje page vjetore ne baze te shpenzimeve te bera per llogari te shoqerise.

Neni 43

Anetaret e keshillit administrativ ose administratori I vetem jane te shfuqizueshem nga asamblea ne cdo kohe me votim te shumices se ortakeve qe perfaqesojne me shume se gjysmen e kapitalit,sipas **nenit 55 te ligjit 7638/92.** Me perjashtim te se drejtes se administratoreve per zhdemtim te demeve,ne rast terheqje pa te drejte.

Neni 44

Keshilli administrativ ose administratori I vetem kane me shume te drejta per administrimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerise,pa perjashtim te asnje lloji dhe ka te drejten e e permbushjes te te gjitha akteve qe e sheh te arsyeshme per arritjen e qellimeve te shoqerise,perjashtuar vetem ata qe ka te drejte vetem asamblea.
Keshilli administrativ ose administratori I vetem,ka,ndermjet te tjerave,kompetence per:
a.blerjen,shitjen dhe shkembimin e pasurive te paluajteshme;
b.dorezimin e pasurive te paluajteshme ne shoqeri te tjera te formuara ose duke u formuar;

c.leshimin e garancive te llojeve te ndryshme dhe marrjen persiper te pjesmarrjeve ne baze te nenit 2 te ketij statuti;
d. miratimin e vendosjeve dhe annulimin e ipotekave te ndryshme
e. venien e ipotekave ligjore;
f. autorizimin dhe kryerjen e cdo lloj operazioni prane zyrave publike dhe cdo enti tjeter privat.

## KAPITULLI 5

## FIRMA DHE PERFAQESIMI I SHOQERISE

Neni 45

Administratori i vetem Zn. Andia Pustina eshte i vetmi person qe gezon te drejten e perfaqsimit ligjor te Shoqerise. Nese per drejtimin dhe Administrimin e Shoqerise Ortaku i Vetem do te vendose per Keshill administrativ atehere dispozitat si me poshte do te jene ne fuqi.

Neni 46

Presidentit te keshillit administrativ ose administratorit te vetem I jepet e drejta te japi zbatim te gjitha vendimeve te Keshillit Administrativ cdo here qe nuk vendoset ndryshe.

Neni 47

Presidenti I keshillit administrativ ose administratori i vetem,perfaqesojne shoqerine ne gjykim me te drejten qe te vene ne levizje veprime gjykuese dhe administrative te cdo lloj niveli, gjithashtu te emerojne, persa I perkete avokateve dhe prokuroreve ne gjyq.

Neni 48

Keshilli administrativ gezon te drejten ashtu sikurse presidenti dhe zv/ presidenti te gjitha fuqite e parashikuara ne nenin **50 te ligjit 7638/92.**

Neni 49

Keshillit administrativ I njihet e drejta te emeroje drejtore,e prokuratore te besuar per akte perfundimtare ose kategori aktesh,dhe me te drejten e autorizimit,gjithashtu gjyqsore e miqesore krijues ne prezence te mbledhjes,duke fiksuar per secilin detyra,shperbmlime dhe pjesmarrje ne fitime kur e sheh te domosdoshme.

## KAPITULLI 6

## EKSPERTET KONTABEL TE AUTORIZUAR

NENI 50

Aktiviteti ekonomik I Shoqerise do te kontrollohet nga nje organ I perbere prej nje ose tre eksperte kontabel te autorizuar,te emeruar sipas nenit 60 te ligjit n.7638/92 ne qofte se ne fund te ushtrimit te detyres kane limitet e meposhteme:
-totalin e aktivit te bilancit.....lek
-fitime te shitjeve dhe te sherbimeve

Kontrolli I mesiperm do te mbyllet ne rast se ne ushtrimin e mevonshem dy prej limiteve te meposhteme kapercehen.
Ky organ,I perbere prej me dhume se nje personi,do te formoj keshillin e eksperteve kontabel te autorizuar.
Asamblea e ortakeve emeron presidentin e kolegjit te eksperteve kontabel te autorizuar.

Neni 51

Ekspertet kontabel te autorizuar qendrojne ne kete funksion gjashte vjete dhe jane te rizgjedhshem.

Neni 52

Asamblea me emerimin e eksperteve kontabel te autorizuar cakton shperblimet e tyre.

## KAPITULLI 7

## BILANCI DHE TE LLOGARIA HUMBJE-FITIME

Neni 53

Ushtrimet e detyrave te shoqerise mbyllen ne 31 dhjetor te cdo muaj.

Neni 54

Ne fund te cdo ushtrimi keshilli administrativ (Administratori i Vetem), brenda cdo gjashte muajve,
duhet te procedoj per bilancin e shoqerise.

Neni 55

Bilanci I shoqerise duhet te hartohet nga nje relacion I keshillit administrativ (Administratorit te vetem) duke theksuar administrimin ne sektore te ndryshme me te cilat shoqeria vepron,dhe nepermjet shoqerive te tjera te kontrolluara nga ajo,duke pare vecanerisht investimet,kushtueshmerine dhe cmimet,si edhe faktet me rendesi qe jane verifikuar pas mbylljes se ushtrimit.

Neni 56

Bilanci I shoqerise dhe relacioni administratoreve duhet te mbahen prane selise se shoqerise gjate pesembedhjete diteve qe procedon asamblea e ortakeve,mbledhur per te aprovuar, gjate se cilés ortaket mund te mbajne dhe te kerkojne kopje te shpenzimeve te tyre.
Dokumentat e mesiperme duhet te vendosen ne dispozicion te eksperteve kontabel te autorizuar,te emeruar,te pakten 4 dite para mbledhjes se asamblese qe duhet ti aprovoje.

Neni 57

Ortaku te vetem ose cdo ortak ( ne rastin e shoqerise me shume ortake) gezon te drejten te njoftohet nga administrata mbi zhvillimin e puneve te shoqerise.

## KAPITULLI 8

## SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI

Neni 58

Shoqeria mund te shperndahet me nje vendim te Ortakut te vetem apo asamblese te orakeve, me votim nga oraket qe perfaqesojne te pakten ¾ ekapitalit te shoqerise.
Te tjera arsye :
a.mbarimi I afatit;
b.arritja e objektit te shoqerise ose pamundesia per ta ndjekur ate;
c.pamundesia e funksionimit ose inaktiviteti I asamblese;
d.rastet e tjera parashikohen ne nenin 28 dhe 72 te ligjit 7638/92.

Neni 59

Ne rastet e shperndarjes se paparashikuar te shoqerise anetaret e Keshillit Administrativ ( Administratori i vetem) ne fuqi nga data qe vendosin shkrirjen e shoqerise marrin funksionet dhe pergjegjesi te likujduesve,ne qofte se asamblea e ortakeve (Ortaku i vetem) nuk vendos ndryshe.

Neni 60

Me caktimin e likujdatoritt pushojne funksionet e Keshillit Administrativ.

Neni 61

Likujduesi ose likujduesit, emerohen nga vendimi I asamblese se orakeve me votim te ortakeve qe perfaqesojne shumicen e kapitalit te shoqerise.

Neni 62
Kohezgjatja e mandatit te likujduesve nuk mund te jete me teper se tre vjete dhe mund te riinovohet per arsye te vertetuara nga asamblea e ortakeve me shumicen e kapitalit te shoqerise.

Neni 63

Likujduesi brenda gjashte muajve nga data e mbledhjes se asamblese se ortakeve nga ku prezantohet raporti I aktivit dhe pasivit te shoqerise, para se te procedohet per operazionin e likujdimit.

Neni 64

Likujduesi perfaqeson shoqerine dhe ka te gjitha kopetencat e nevojshme per likujdimin e pasivit dhe aktivit te shoqerise.Eshti I autorizuar te paguaj te gjithe kreditoret dhe t'ju shperndaj ortakeve aktivin e mbetur.

Neni 65

Likujduesi harton brenda tre muajve menjehere pas mbarimit te vitit bilancin vjetor,nga llogaria ekonomike dhe nga iventari,shoqeruar nga nje relazion mbi administrimin e te gjitha veprimeve te bera gjate ushtrimit vjetor.
Asamblea e ortakeve vendos me votim te ortakeve qe perfaqesojne shumicen e kapitalit te shoqerise.

Neni 66

Shperndarja e aktivit qe mbetet pas pagimit te ortakeve kuotat e mbajtura te kapitalit te shoqerise,ndahet ndermjet ortakeve ne proporcion te kuotave pjesmarrese nga posedimi ityre ne kapitalin e shoqerise.
Ne qofte se aktivi qe eshte per t'ju shperndare ortakeve eshte I perbere nga te objekte te palevizshme ose impiante ose nga te drejta mbi to,procedohet me shitjen me cmim te njejte me ate te tregut dhe fitimi shperndahet ne proporcion te kuotave pjesmarrese ne kapitalin e shoqerise.

## KAPITULLI 9

## SITUATA TE TJERA

Neni 67

Te gjitha mosmarreveshjet, zgjidhen nga Gjykata e Tiranes sipas rregullave te saj.Ligji qe aplikohet eshte ai shqiptar.

Neni 68

Per ate qe nuk eshte parashikuar ne kete statut,I duhet referuar normave ligjore ne fuqi.

Neni 69

Ky akt perpilohet ne kater kopje origjinale me te njejten vlere juridike per:

- Gjykaten e rrethit te Tiranes per te bere veprimet ne Regjistrin Tregtar dhe njohjen si person juridik te kesa Shoqerie
- Zyren e Tatimeve per marrjen e lejes se ushtrimit te veprimtarise

- Dhomen e Noterise
- një kopje mbetet si pjese e dokumentacionit te themelimit te shoqerise tregtare "SCORPION" sh.p.K.

**ORTAK I VETEM**

**I SHOQERISE TREGTARE**

"SCORPION" sh.p.k."

Eligio Romanazzi

# STATUTI
# I
# SHOQËRISË ANONIME PA OFERTË PUBLIKE
# "TELENORBA SHQIPTARE" SH.A.

## TITULLI I
## EMRI I SHOQËRISË - SELIA - KOHËZGJATJA

### Neni 1 - Forma

1.1. Shoqëria "TELENORBA SHQIPTARE" Sh.A. më poshtë referuar si "Shoqëria") është themeluar në formën e shoqërisë anonime pa ofertë publike dhe rregullohet nga ky Statut dhe nga Akti i Themelimit.

1.2. Shoqëria vepron në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

1.3. Akti i Themelimit dhe Statuti janë në përputhje me legjislacionin shqiptar, me të cilin nuk mund të bien në kundërshtim dhe çdo gjë që nuk rregullohet drejpërdrejtë nga legjislacioni shqiptar, rregullohet prej tyre.

### Neni 2 - Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë është "TELENORBA SHQIPTARE" Sh.A.

### Neni 3 - Selia dhe Kohëzgjatja

3.1. Selia e Shoqërisë është në Tiranë, Rruga Ismail Qemali, 27.

3.2. Shoqëria mund të hapë filiale, agjensi dhe përfaqësi në qytete të tjera të tjera të Shqipërisë edhe jashtë vendit, me vendimin e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionarëve.

3.3. Drejtoria mund të vendosë hapjen ose mbylljen e çdo zyre tjetër pa përfaqësi të përhershme, si në Shqipëri ashtu dhe jashtë.

3.4. Për të gjitha njoftimet që lidhen me marrëdhëniet ndërmjet Shoqërisë dhe Aksionarëve, vendbanimi i çdo aksioneri është ai i përcaktuar në regjistrin e Aksionarëve.

3.5. Kohëzgjatja e Shoqërisë është 50 (pesëdhjetë) vjet duke filluar nga regjistrimi i Shoqërisë në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë. Një kohëzgjatje e tillë mund të zgjatet në vijim me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionarëve.

## TITULLI II

## OBJEKTI

### Neni 4 – Objekti

4.1 Objekti i Shoqërisë është aktiviteti radioteleviziv privat. Ajo përfshin prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve të çdo lloji me anë të zërit, figurës, sinjaleve të koduara, shkrimit, të destinuara për publikun nëpërmjet valëve elektromagnetike, kabllove, përsëritësve, satelitëve apo me çdo mjet tjetër.

4.2 Aktiviteti i Shoqërisë do kryhet duke respektuar paanshmërisht të drejtën për informacion, bindjet politike e besimet fetare, personalitetin, dinjitetin, jetën private të njeriut, si dhe të drejtat dhe liritë themelore të tij.

4.3 Shoqëria mund të financohet nëpërmjet reklamës dhe sponsorizimeve në përputhje me sa parashikon legjislacioni në fuqi.

4.4. Aktiviteti i Shoqërisë do të zhvillohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe në në mënyrë të veçantë me ligjin nr. 7638, të datës 19 nëntor 1992, *"Për Shoqëritë Tregtare"*, me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme dhe ligjin nr. 8410, i datës 30 shtator 1998 *"Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë* me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme.

4.5. Sipas legjislacionit në fuqi dhe për arritjen e objektit të Shoqërisë dhe të qëllimeve të saj, Shoqëria mund:

- të kryejë të gjitha veprimet në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë që lidhen qëllimin e mësipërm - të marrë edhe interesa jo aksionere, në Shoqëri, agjensi, ente dhe ndërmarrje, të cilat mund të kenë edhe qëllime të tjera por që funksionalisht lidhen me aktivitetin televiziv;

- jep garanci, mund të hipotekojë në favor të ndonjë banke, instituti krediti dhe financiar.

4.6. Shoqëria mund të kryejë shërbimet e sipërpërmendura si drejtëpërsëdrejti ashtu edhe nëpërmjet konsulentëve ose të tretëve.

4.7. Shoqëria mund të marrë pjesë në tendera dhe të kërkojë financime në Shqipëri dhe jashtë vendit.

## TITULLI III
## AKSIONET – KAPITALI

### Neni 5 – Kapitali i Shoqërisë

5.1. Kapitalit themeltar i Shoqërisë është caktuar 70.000.000 (shtatëdhjetë milion) lekë i ndarë në 70.000 (shtatëdhjetmijë) aksione nominative dhe të regjistruara me një vlerë nominale prej 1.000 (njëmijë) lek secila. Kapitali i Shoqërisë formohet nga kontributet mëposhtme në para dhe në natyrë të Ortakëve Themelues:

1. Z. Eligio ROMANAZZI, ka nënshkruar 10.040 (dhjetëmijë e dyzet) aksione, që u korrespondojnë 14,35 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë, nëpërmjet:

   a. kalimit të së drejtës së pronësisë së pajisjeve, siç është përcaktuar më saktë në inventarin që i bashkëngjitet raportit të ekspertit Nexhip ÇEÇI, i përgatitur më 03 prill 2000 (Shtojca 1) Në bazë të nenit 91 të ligjit 7638, datë 19 nëntor 1992 "*Për Shoqëritë Tregtare*", vlera e kontributit të së drejtës së pronësisë është vlerësuar në shumën prej 4.900.000 (katër milion e nëntëqindmijë) lekë;

   b. depozitimin në para të shumës të barabartë me 5.140.000 (pesë milion e njëqind e dyzetmijë) nëpërmjet depozitimit të 25 % të kësaj shume të barabartë me 1.285.000 (një milion e dyqind e tetëdhjetëepesëmijë) në llogarinë rrjedhëse nr. 16132, të hapur pranë Bankës Italo-Shqiptare, selia Tiranë, në favor të Shoqërisë në krijim e sipër "TELENORBA SHQIPTARE" Sh.A. (Shtojca 6)

2. Shoqëria "SCORPION" Sh.p.k. ka nënshkruar 16.560 (gjashtëmbëdhjetëmijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) aksione, që i korrespondojnë23,65 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë, nëpërmjet kalimit të së drejtës së pronësisë të një apartamenti me një sipërfaqe të përgjithshme prej 130 (njëqind e tridhjetë) m2, të ndodhur në Tiranë, siç është përcaktuar më saktë në letrën e transkriptimit të Zyrës së Hipotekës së Tiranës nr. 1818 të 29 prill 1998 bashkëngjitur raportit të ekspertit Z. Bujar BASHA, të përgatitur më 20 mars 2000 (Shtojca 2). Në bazë të nenit 91 të ligjit 7638, datë 19 nëntor 1992 "*Për Shoqëritë Tregtare*", vlera e kontributit të së drejtës së pronësisë është vlerësuar në një shumë të përgjithshme prej 16.560.000 (gjashtëmbëdhjetë milion e pesëqind e gjashtëdhjetëmijë) lekë;

3. Z. Donato D'ALESSANDRO, ka nënshkruar 28.000 (njëzet e tetëmijë) aksione, që u korrespondojnë 40 % të kapitalit të Shoqërisë, nëpërmjet kalimit të së drejtës së pronësisë së pajisjeve, siç është përcaktuar më saktë në inventarin që i bashkëngjitet raportit të ekspertit Naxhip ÇEÇI, i përgatitur më 3 prill 2000 (Shtojca 3). Në bazë të nenit 91 të ligjit 7638, datë 19 nëntor 1992 "*Për Shoqëritë Tregtare*", vlera e kontributit të së drejtës së pronësisë është vlerësuar në një shumë të përgjithshme prej 28.000.000 (njëzet e tetë milion) lekë;

4. Z. Giovanni D'ALESSANDRO, ka nënshkruar 15.400 (pesëmbëdhjetë e katërqind) aksione, që u korrespondojnë 22 % të kapitalit të Shoqërisë, nëpërmjet kalimit të së drejtës së pronësisë së pajisjeve, siç

është përcaktuar më saktë në inventarin që i bashkëngjitet raportit të ekspertit Nexhip ÇEÇI, i përgatitur më 03 prill 2000 (Shtojca 4). Në bazë të nenit 91 të ligjit 7638, datë 19 nëntor 1992 "*Për Shoqëritë Tregtare*", vlera e kontributit të së drejtës së pronësisë është vlerësuar në një shumë të përgjithshme prej 15.400.000 (pesëmbëdhjetë milion e katërqindmijë) lekë;

5.2. Pjesa e kapitalit të Shoqërisë që mbetet për t'u depozituar në para do të paguhet në përputhje me atë që do të përcaktohet me vendim të Drejtorisë.

5.3. Çdo aksion është i pandashëm dhe siguron të drejtën e një vote.

5.4 Transferimi *inter vivos* i aksioneve të Shoqërisë i nënshtrohet të drejtës së parablerjes në favor të Aksionarëve të tjerë, të cilët mund të ushtrojnë këtë të drejtë brenda 20 ditësh nga marrja e letrës së dërguar me postë rekomande ose me faks që përmban ofertën e blerjes. Të gjitha njoftimet e parashikuara në këtë nen duhet t'i adresohen edhe Shoqërisë.

5.5 Në rastin e rritjes së kapitalit të Shoqërisë, aksionet e reja i ofrohen Aksionarëve në proporcion me numrin e aksioneve të zotëruara prej tyre, në bazë të Nenit 155 dhe më pas, të ligjit Nr. 7638, datë 19 nëntor 1992 "*Mbi Shoqëritë Tregtare*" dhe me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme.

5.6. Në rast shkatërrimi ose humjeje të çertifikatës Drejtoria mund të lëshojë çertifikata të reja Drejtoria mund të përcaktojë afatet dhe kushtet që i konsideron të nevojshme dhe mund të kërkojë dëmshpërblimet e konsideruara të përshtatshme, për të mbrojtur Shoqërinë nga ndonjë padi e cila mund të ngrihet kundër saj lidhur me çfarëdo lloj çertifikate e cila pretendohet të ketë humbur ose të jetë shkatërruar.

## TITULLI IV
## ASAMBLEJA E AKSIONARËVE

### Neni 6 – Asambleja e Aksionarëve

6.1 Organi vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Aksionarëve, e cila përbëhet prej të gjithë Aksionarëve të Shoqërisë. Asambleja e Aksionarëve mund të jetë e zakonshme ose jashtëzakonshme. Asambleja e Aksionarëve mund të mblidhet në Shqipëri dhe jashtë. Njoftimi për thirrjen do të tregojë vendin dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.

6.2 Asambleja e Aksionarëve thirret nga Kryetari i Këshillit Mbikqyrës ose nga Drejtori. Ajo mund të thirret gjithashtu në përputhje me Nenin 132 të Ligjit nr. 7638, datë 19 nëntor 1992, *"Për Shoqëritë Tregtare"* me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme.

6.3 Thirrja e Asamblesë së Aksionarëve mund të bëhet dhe nga aksionarët që përfaqësojnë të paktën 1/10 (një të dhjetën) e kapitalit të Shoqërisë.

6.4 Asambleja e Aksionarëve do të konsiderohet e thirrur në mënyrën e duhur edhe nëse nuk janë respektuar formalitetet që rregullojnë një thirrje të tillë, me kusht që në një Asamble të tillë të marrin pjesë të gjithë aksionarët personalisht apo të përfaqësohen me prokurë, të gjithë drejtorët dhe të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikqyrës.

6.5 Aksionerët të cilët janë regjistruar që prej të paktën 5 (pesë) ditësh në regjistrin e Aksionarëve dhe aksionarët të cilët depozitojnë aksionet e tyre në bazë të udhëzimeve dhe afateve të përcaktuara në njoftimin e thirrjes mund të marrin pjesë në Asamblenë e Aksionarëve.

6.6 Të gjitha Asambletë e Aksionarëve drejtohen nga Drejtori apo në vend të tij nga Zëvendës Drejtori, ose, nëse këta persona nuk janë të disponueshëm, nga një Anëtar i Drejtorisë apo edhe nga një aksionar i emëruar nga Asambleja e Aksionarëve. Asambleja e Aksionarëve emëron një sekretar të Asamblesë, i cili mund të mos jetë edhe aksionar.

6.7 Aksionarët mund të zgjedhin që të përfaqësohen në Asamblenë e Aksionarëve, me një prokurë të shkruar, nga një aksionar tjetër ose nga bashkëshorti/ja e tij/saj.

6.8 Drejtori ka kompetenca të plota për të verifikuar prokurat dhe rregullsinë e tyre, të drejtat e Aksionarëve dhe përfaqësuesve të tyre për të marrë pjesë në Asamblenë e Aksionarëve dhe të vendosë nëse ajo është e mbledhur rregullisht dhe nëse është i pranishëm quorumi i Aksionarëve me qëllim që të merren vendime të vlefshme. Ai ka gjithashtu të drejtën të drejtojë diskutimet dhe të përcaktojë metodat dhe procedurat e votimit.

6.9 Procesverbalet e asambleve nënshkruhen nga Drejtori dhe nga sekretari.

## Neni 7 - Asambleja e Zakonshme

7.1 Asambleja e Zakonshme duhet të mbahet të paktën një herë në vit, brenda 6 muajsh nga fundi i vitit financiar, me qëllim që të diskutohet, shqyrtohet dhe miratohet bilanci i vitit të kaluar financiar.

7.2 Në përputhje me sa parashikohet nga neni 20 i ligjit 8410 datë 30 shtator 1998, "*Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë*", dhe me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme, Asambleja e Zakonshme e Aksionarëve është vlefshmërisht e mbledhur në thirrjen e parë dhe të dytë kur është e pranishme apo e përfaqësuar me prokurë, të paktën 2/3 e kapitalit. Asambleja e Zakonshme e Aksionarëve merr vendim me shumicën e kapitalit, të pranishëm apo të përfaqësuar.

## Neni 8 - Asambleja e Jashtëzakonshme

8.1 Dispozitat e Statutit mund të ndryshohen vetëm me një vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme.

8.2. Në përputhje me sa parashikohet nga neni 20 i ligjit 8410 datë 30 shtator 1998, "*Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë*", me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme, Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionarëve është vlefshmërisht e mbledhur në thirrjen e parë dhe të dytë kur është e pranishme apo e përfaqësuar me prokurë, të paktën 2/3 e kapitalit.

8.3 Në rast se ky quorum nuk arrihet që në thirrjen e parë, mbledhja e dytë e Asamblesë mund të shtyhet për një datë të mëvonshme, por jo më vonë se 2 muaj nga data e thirrjes së mbledhjes së parë.

8.4 Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionarëve vendos me një shumicë prej 3/4 (tre të katërtat) e kapitalit të Shoqërisë, të pranishëm apo të përfaqësuar.

## TITULLI V
## ADMINISTRIMI I SHOQËRISË - KËSHILLI MBIKQYRËS

### Neni 9 - Përbërja dhe Emërimi i Anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës

9.1 Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga 3 (tre) anëtarë deri në 21 (njëzet e një) anëtarë në bazë të vendimit të marrë nga Asambleja e aksionarëve.

9.2 Në bazë të neneve 93 dhe 105 të ligjit nr. 7638, datë 19 nëntor 1992, "*Për Shoqëritë tregtare*" dhe me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme,. Anëtarët e parë të Këshillit Mbikqyrës janë:

1. Kryetari i Këshillit Mbikqyrës
Z. Donato D'ALESSANDRO, qytetar italian, lindur në Bari (BA), Itali, më 27 qershor 1961, dhe banues në Conversano (BA), Itali, me Pas. nr. 598874S (me adresë në Shqipëri: Rruga Ismail Qemali, 27, Tirana).

2. Zëvendës Kryetari i Këshillit Mbikqyrës
Z. Giovanni D'ALESSANDRO, qytetar italian, lindur në Conversano (BA), Itali, më 12 mars 1942, dhe banues në Conversano (BA) Itali, me Pas. nr. 598048S (me adresë në Shqipëri: Rruga Ismail Qemali, 27, Tirana).

3. Anëtar i Këshillit Mbikqyrës
Znj. Andia PUSTINA, qytetare shqiptare, lindur në Tiranë, më 20 janar 1971, dhe banuese në Tiranë Rruga Don Bosco, Pall. Al_Mak, B-4, Ap. 29, me Pas. nr. 0815749.

9.3. Mandati i anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës është 3 (tre) vjet dhe ata mund të rizgjidhen. Anëtarët e emëruar nga Mbledhja e Aksionarëve mund të revokohen për çfarëdo arsye nga Mbledhja e Zakonshme e Aksionarëve. Anëtarët e emëruar nga punëmarrësit mund të revokohen në përputhje me ligjin ose nga ky Statut.

9.4 Në rast vdekjeje, shkarkimi apo dorëheqje, vendet vakant në Këshillin Mbikqyrës duhet të zëvendësohen brenda 3 muajsh. Anëtari i Këshillit Mbikqyrës, i emëruar për të zëvendësuar një anëtar tjetër, do të qëndrojnë në post për të gjithë kohën e mbetur të mandatit të paraardhësit.

9.5 Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës nuk mund të marrin pjesë në më shumë se 9 (nëntë) Këshilla Mbikqyrës të tjerë të shoqërive anonime, të cilat kanë selinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

9.6 Asambleja e Aksionarëve mund të caktojë shpërblim për anëtarët e Këshillit Mbikqyrës siç është parashikuar nga ligji.

## Neni 10 - Kryetari dhe Zëvendës Kryetari i Këshillit Mbikqyrës

10.1 Këshilli Mbikqyrës emëron një Kryetar dhe një Zëvendës Kryetar nga anëtarët e tij të cilët janë caktuar të thërrasin mbledhjet e Këshillit dhe drejtojnë diskutimet

10.2 Kryetari dhe Zëvendës Kryetari i Këshillit mund të marrin shpërblim shtesë, të caktuar nga Këshilli.

10.3 Këshilli Mbikqyrës mund të emërojë herë pas herë një sekretar qoftë edhe jo nga anëtarët e tij.

10.4 Në rast mungese të Kryetarit, mbledhjet e Këshillit drejtohen nga Zëvendës Kryetari.

## Neni 11 - Mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës

11.1 Këshilli Mbikqyrës mblidhet rregullisht të paktën një herë në tre muaj dhe sa herë që konsiderohet e nevojshme. Thirrja bëhet nga Kryetari ose në mungesë të tij, nga Zëvendës Kryetari.

11.2 Kryetari duhet të thërrasë Këshillin Mbikqyrës brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga kërkesa e motivuar prej të paktën 1/3 (një të tretës) së anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës. Nëse kjo kërkesë mbetet pa përgjigje, kërkuesi mund të thërrasë mbledhjen e Këshillit, duke përcaktuar rendin e saj të ditës.

11.3 Thirrja bëhet të paktën 3 (tre) ditë para mbledhjes, me anë të një letre rekomande, telegrami, teleksi, telefaksi ose e-mail. Thirrja mund të jetë e vlefshme edhe kur është gojore apo pa ndonjë afat kohor nëse të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikqyrës do ta pranojnë atë.

11.4 Çdo thirrje përmban rendin e ditës.

11.5 Mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës zhvillohen në selinë e shoqërisë ose në çfarëdo vendi tjetër të treguar në thirrje.

11.6 Procesverbali mbahet nga sekretari dhe nënshkruhet nga ai dhe nga Kryetari i Këshillit Mbikqyrës. Procesverbalet mbahen në një regjistër të veçantë.

11.7 Këshilli Mbikqyrës nuk mund të marrë vendime të vlefshme pa praninë e të paktën gjysmës së anëtarëve të tij. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Në raste votash të barabarta, vota e Kryetarit është vendimtare.

## Neni 12 - Kompetencat e Këshillit Mbikqyrës

12.1 Këshilli Mbikqyrës emëron anëtarët e Drejtorisë, dhe është përgjegjëse për mbikqyrjen e politikave dhe aktiviteteve të Shoqërisë.

12.2 Këshilli Mbikqyrës ka përgjegjësinë të sigurojë që aktivitetet dhe funksionimi i Shoqërisë janë në përputhje me ligjin. Ai rishikion dhe mbikqyr çdo situatë aktuale apo të mundshme konflikti interesash dhe, në përputhje me ligjin, merr prej anëtarëve të Drejtorisë të gjitha njoftimet e konflikteve aktuale apo të mundshme të interesave që ata mund të kenë me Shoqërinë. Këshilli Mbikqyrës nxjerr udhëzime në lidhje me ruajtjen e sekretit dhe konfidencialitetit për informacionet në lidhje me Shoqërinë si dhe kontrollon zbatimin e tyre të drejtë.

12.3 Këshilli Mbikqyrës ka të drejtë të kryejë të gjitha verifikimet dhe mbikqyrjet që i quan të përshtatshme për përmbushjen e të gjitha detyrave të tij.

12.4 Këshilli Mbikqyrës i paraqet Asamblesë së Aksionarëve komentet e tij mbi raportin vjetor të nxjerrë nga Drejtoria në përputhje me Nenin 130 të Ligjit nr. 7638, datë 19 nëntor 1992, "*Për Shoqëritë tregtare*" dhe me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme.

12.5 Këshilli Mbikqyrës kontrollon aktivitetin e Drejtorisë, miraton kriteret e marrjes në punë, vendet e punës dhe shpërblimet e punonjësve të shoqërisë dhe jep autorizimin për lidhjen e të gjitha marrëveshjeve që kërkojnë autorizim në bazë të Ligjit.

# TITULLI VI
# ADMINISTRIMI - DREJTORIA - KËSHILLI MBIKQYRËS - BORDI DREJTUES

## Neni 13 - Drejtoria

13.1 Shoqëria drejtohet nga një Drejtori e përbërë nga një numër prej 1 (një) deri në 7 (shtatë) Drejtorë, në bazë të vendimit të marrë nga Këshilli Mbikqyrës. Këshilli Mbikqyrës emëron Drejtorin ndërmjet Drejtorëve të emëruar, dhe nëse është e nevojshme, një Zëvendës Drejtor dhe një apo më shumë Drejtorë Administrativë, të cilëve Drejtoria mund t'u delegojë disa nga kompetencat e saj. Drejtorët mund edhe të mos jenë aksionarë.

13.2 Drejtorët emërohen për një afat prej 2 (dy) vitesh me të drejtë rizgjedhjeje.

13.3 Drejtori ose në mungesë të tij, Zëvendës Drejtori është përfaqësuesi ligjor i shoqërisë. Këshilli Mbikyrës gjithashtu mund t'i japë Zëvendës Drejtorit dhe Drejtorit Administrativ, nëse ka, ose një Drejtori kompetencën të përfaqësojnë shoqërinë së bashku apo më vete.

13.4 Përfaqësuesit e mësipërm ligjorë të shoqërisë mund të emërojnë një përfaqësues "ad negotia" për ushtrimin e detyrave apo kategorive të detyrave të veçanta, brenda kufijve të kompetencave të dhëna.

13.5 Këshilli Mbikqyrës mund të vendosë shpërblime për anëtarët e Drejtorisë në momentin e emërimin e tyre.

13.6 Anëtarët e Drejtorisë mund të shkarkohen nga Këshilli Mbikqyrës në çdo kohë për arsye të ligjshme, në bazë të dispozitave ligjore ose për mosekzistencën e raportit të besimit me Shoqërinë.

13.7 Në rast të ndonjë vendi bosh në Drejtori për shkak vdekje, dorëheqje, shkarkimi, paftësi në punë të një prej anëtarëve të tij apo çdo shkaku tjetër, pasardhësi që do të plotësojë vendin do të zgjidhet nga Këshilli Mbikqyrës në mbledhjen e parë që ndjek lënien bosh të vendit. Drejtori i zgjedhur në këtë mënyrë do të qëndrojë në detyrë për gjithë kohën e mbetur të mandatit të parardhësit të tij. Nëse shumica e anëtarëve të Drejtorisë heq dorë nga detyra, Këshilli Mbikqyrës duhet menjëherë të procedojë për emërimin e një Drejtorie të re.

## Neni 14 - Mbledhja e Drejtorisë

14.1 Drejtori thërret mbledhjen e Drejtorisë, nëse ajo ekziston, duke përcaktuar rendin e ditës, në çdo kohë që e quan të nevojshme apo në rast se ai merr një kërkesë me shkrim nga të paktën 1/3 (një e treta e anëtarëve të Drejtorisë). Kërkesa duhet të përmbajë listën e çështjeve apo temave që duhen diskutuar. Në rast se Drejtori refuzon të thërrasë mbledhjen brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e kërkesës, mbledhja mund të thirret nga kërkuesit. Drejtoria do të thirret me anë të një letre rekomande, telegrami ose telefaksi, ose e-mail të dërguar të paktën 3 (tre) ditë përpara mbledhjes. Në rast urgjence mbledhja mund të thirret nga telegrami, telefaksi apo e-maili të dërguar një ditë para ditës së caktuar të mbledhjes. Në rast se Drejtori mungon ose për ndonjë arsye nuk ka mundësi të marrë pjesë në mbledhje, të gjitha funksionet e përcaktuara në këtë nen i transferohen Zëvendës Drejtorit, nëse ka, ose Drejtorit më të vjetër në detyrë. Drejtoria do të mblidhet në mënyrë të vlefshme edhe nëse nuk është bërë njoftimi formal i thirrjes, me kusht që të gjithë Drejtorët të jenë të pranishëm dhe të informuar mbi rendin e ditës që do të diskutohet.

14.2 Drejtoria mund të emërojë një Sekretar për të mbajtur procesverbalin dhe verifikimin e firmës së Drejtorit në to, ose në rast se ai mungon, me një prej anëtarëve të pranishëm. Sekretari mund të jetë edhe një person i cili nuk është anëtar i Drejtorisë.

14.3 Mbledhjet e Drejtorisë do të mbahen të paktën një herë në tre muaj, në selinë e shoqërisë ose në një vend tjetër, në Shqipëri apo jashtë, dhe mund të zhvillohen edhe me telekonferencë ose videokonferencë, ose me anë të mjeteve të ngjashme elektronike, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të identifikohen dhe tu jepet mundësia të ndjekin diskutimet dhe të marrin pjesë aktive në to. Nëse ekzistojnë këto kushte Drejtoria quhet e mbledhur në vendin ku ndodhen Drejtori dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllim që të mbajnë procesverbalin dhe t'i firmosin ato.

14.4 Mbledhjet e Drejtorisë quhen të mbledhura në mënyrë të vlefshme kur janë të pranishëm shumica e Drejtorëve. Vendimet e Drejtorisë janë të vlefshme kur miratohen me votën pro të shumicës së Drejtorëve të pranishëm. Në rast votash të barabarta, vota e Drejtorit është vendimtare.

## Neni 15 - Kompetencat e Drejtorisë

15.1 Drejtorisë i jepen të gjitha kompetencat në lidhje me administrimin e Shoqërisë për arritjen e qëllimit të Shoqërisë, me përjashtim të atyre kompetencave që ligji apo Statuti ia rezervon organeve të tjera. Kufiri maksimal i shpenzimeve të autorizuara është i barabartë me 700.000 (shtatëqindmijë) lekë për çdo zë shpenzimesh. Çdo shpenzim mbi këtë kufi duhet paraprakisht të autorizohet nga Këshilli Mbikqyrës.

15.2 Drejtoria do të jetë përgjegjëse për përgatitjen dhe ruajtjen dokumentacionit financiar të duhur në përputhje me Ligjin. Drejtoria duhet t'i paraqesë një raport Këshillit Mbikqyrës çdo tre muaj, dhe do të jetë përgjegjëse për paraqitjen e bilancit vjetor, brenda tre muajve nga data e mbylljes së vitit financiar, me qëllim që të verifikojë dhe kontrollojë atë.

## Neni 16 – Bordi Drejtues

16.1. Drejtoria mund të emërojë një Bord Drejtues, të cilit mund t'i kërkojë mendim, i cili nuk ka fuqi detyruese mbi disa çështje të rëndësisë së veçantë në drejtimin e aktivitetit të Shoqërisë.

16.2. Bordi Drejtues do të përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë të zgjedhur ndërmjet personave me moral dhe prestigj të padiskutueshëm. Nuk do të ketë mospërputhje midis detyrës së anëtarit të Bordit Drejtues dhe një funksioni tjetër në Shoqëri.

16.3. Anëtarët e Bordit Drejtues qëndrojnë në detyrë për 2 (dy) vjet dhe mund të rizgjidhen.

# TITULLI VII
# KONTABILITETI, VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR

## Neni 17 – Ekspertët Kontabël

17.1 Kontrolli kontabël i brendshëm i shoqërisë kryhet nga dy ekspertë kontabël të autorizuar, të emëruar për 1 (një) vit financiar.

17.2 Ekspertë kontabël emërohen nga Asambleja e Zakonshme.

17.3 Në bazë të Nenit 93 të Ligjit nr. 7638, datë 19 nëntor 1992, "*Për Shoqëritë tregtare*" dhe me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme, Ekspertë kontabël të parë emërohen:
Z. Berti PASHKO
Z. Peri BUZALI

## Neni 18 - Viti Financiar – Inventari – Bilanci

18.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbyllet më 31 dhjetor të çdo viti.

18.2 Drejtoria mban një regjistër të rregullt të pasurisë dhe të aktivitetit të tij, në përputhje me ligjin. Në fund të vitit financiar, Drejtoria harton dhe bilancin vjetor për atë vit financiar.

## Neni 19 – Rezultati i Vitit Financiar dhe Përcaktimi i Fitimit

19.1 Drejtoria harton bilancin vjetor në përputhje me ligjin. 5% e fitimit neto që rezulton nga bilanci i miratuar në bazë të dispozitave të Ligjit mbahet për rezervën kryesore deri sa kjo rezervë të arrijë 10% të kapitalit të shoqërisë.

19.2 Fitimi i mbetur shpërndahet ose kalon në fondin rezervë në bazë të vendimit të marrë nga Asambleja e Aksionarëve për shpërndarjen e dividentëve.

## Neni 20 – Likuidimi dhe Mbyllja

20.1 Shoqëria quhet e mbyllur në rastet e parashikuara në Ligj. Në rast mbyllje, Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionarëve emëron një apo më shumë likuidatorë, duke u dhënë atyre kompetencat përkatëse.

20.2 Shoqëria mund gjithashtu të shpërndahet apo të bashkohet me një tjetër me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionarëve.

# TITULLI VIII
# DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

## Neni 21 –Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

21.1. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin, zbatimin apo zgjidhjen e këtij Statutit dhe të Aktit të Themelimit të Shoqërisë dhe, si edhe ato që mund të lindin midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet të interesuarve.

21.2. Në rast se nuk arrihet në një zgjidhjeje miqësore të mosmarrëveshjes, ajo mund t'i besohet një gjykate shqiptare, përveç rastit kur ortakët italianë ushtrojnë të drejtën e tyre për të kërkuar besimin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes nga arbitrazhi. Arbitrazhi përbëhet prej 3 (tre) arbitrash, 2 (dy) prej të cilëve emërohen respektivisht prej palëve, dhe i 3 (treti) me funksionin e kryetarit, i emëruar nga arbitrat, ose në rast se nuk arrihet në mirkuptim për zgjedhjen e kryetarit brenda 5 (pesë) ditëve nga emërimi i arbitrit të dytë, do të caktohet prej Kryetarit të Gjykatës së Tiranës brenda 30 ditësh prej bërjes së kërkesës prej palës më të interesuar. Gjithsesi, përpara krijimit të Gjykatës së Arbitrave, secila prej palëve mund të kërkojë marrjen e masave të jashtëzakonshme për të siguruar objektin e padisë prej Gjykatës së Tiranës. Këto masa do të konfirmohen ose revokohen prej Gjykatës së Arbitrave pas krijimit të saj.

21.3. Arbitrazhi do të vendosë me paanësi e në mënyrë të njëllojtë për palët duke depozituar vendimin brenda 90 ditëve prej datës së pranimit të detyrës së arbitrit të tretë. Vendimi i Kolegjit të Arbitrave është i paapelueshëm

21.4. Vendi i arbitrimit do të jetë Tirana. Gjuha e arbitrimit do të jetë gjuha italiane.

## Neni 22 - Gjuha

Ky Statut është përgatitur në katër kopje në gjuhën italiane duke i bashkëngjitur përkthimin në gjuhën shqipe. Për të gjitha konfliktet që mund të lidhen me interpretimin dhe/ose zbatimin e Statutit, versioni italisht do të jetë i vetmi me fuqi ligjore.

* * * * *

Tiranë 19 prill 2000

Ortakët Themelues:

Z. Eligio ROMANAZZI

Z. Donato D'ALESSANDRO

Për Shoqërinë SCORPION Sh.p.k
Znj. Andia PUSTINA

Z. Giovanni D'ALESSANDRO

Përkthyese
Lena Çollaku

# P R O K U R Ë

I nënshkruari Inxh. Luca Montrone lindur në Comversano (Ba) më 26 Korrik 1936, në cilësinë e Presidentit dhe Përfaqsuesit Ligor të shoqërisë TELENORBA S.P.A me seli në Conversano (Ba) në Rr. Pantaleo 20/A

## EMËRON DHE NGARKON

1) person të autorizuar znj. Vincenza Pipoli, lindur në Bari më 03 qershor 1965 dhe residente në Polignano a Mare (Bari) contrada serre 742/A, kod fiskal PPLVCN65H43A662F, me qëllim që ta përfaqsojë dhe zëvendësojë për hartimin e kontratës së blerjes ose të parablerjes së aksioneve deri në një numër maksimal prej nr. 96 750 (nëntëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) aksionesh me vlerë nominale prej 1.000 (njëmijë) Lekë që përfaqson 45% të kapitalit themeltar të shoqërisë shqiptare Telenorba Shqiptare me seli në Tiranë Shqipëri në Rrugën Ismail Qemali, 27 me numër regjistrimi në Gjykatën e Tiranës n. 23723 dhe kod fiskal me nr. 3708619 Nipt. K017110041 me kapital themeltar të derdhur i gjithi prej 215.000.000 lekë në të gjitha selitë e përshtatshme dhe në dokumente. Në rast nevoje, i nënshkruari Përfaqsuesi Ligjor i kalon personit të autorizuar të përmendur më sipër kompetenca të plota për përfundimin e operacionit të përmendur më sipër, përfshi këtu nënshkrimin e dokumentave përkatëse, si dhe çdo gjë tjetër që është e nevojshme duke i konsideruar të vlefshme veprimet e tij të deritanishme.

Nr. I Listës. 515277 – REPUBLLIKA ITALIANA

VËRTETIMI I NËNSHKRIMIT

Unë i nënshkruari Z. FRANCESCO REBOLI, Noter në Bari, regjistruar në Dhomën e Notereve të Rrethit të Barit, vërtetoj, se ka firmosur sot në praninë time dokumentin paraardhës, Inxh. MONTRONE LUCA lindur në Conversano (Ba) më njëzet e gjashtë korrik 1939, në cilësinë e Presidentit dhe Përfasuesit ligjor të Shoq. Pantaleo N. 20/A, ku banon për arsye detyre, identitetin personal, detyrën dhe kompetencat e të cilit i vërtetoj unë Noteri.

Bari, pesë dhjetor dymijë e gjashtë, në zyrën time në Rrugën Putignani 12/A.

545/2006

PROKURORIA E REPUBLIKËS- BARI

Viza, legalizohet, për delegim
të Ministrit të Drejtësisë, firma e
Z. Francesco Reboli
Noter në
Bari,
qëllimisht mbi këtë dokument për të qenë i
vlefshëm jashtë shtetit
Bari, 6 dhjetor 2006
Prokurori i Republikës
Z. Giuseppe CARABBA

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**NOTERIA TIRANE**
**N. 2690 Rep.**

# VERTETIM

**Une i neneshkruari, Agim Xh. Robo, noter ne qytetin e Tiranes, Rruga Ismail Qemali, P. 27/1, vertetoj se kam perkthyer sa me siper nga italishtja ne shqip, njelloj me origjinalin.**

**Tirane, me 19.03.2007**

NOTER
Agim Xh. Robo









# PROCURA SPECIALE

IL sottoscritto Ing. Luca Montrone nato a Conversano (Ba) il 26 Luglio 1939, in qualita' di Presidente e Legale Rappresentante della società TELENORBA S.P.A. con sede in Conversano (Ba) alla Via Pantaleo 20/A

## NOMINA E COSTITUISCE

1) suo procuratore speciale la dott.sa Vincenza Pipoli, nata a Bari il 03 giugno 1965 e residente a Polignano a Mare (Bari) contrada serre 742/A, codice fiscale PPLVCN65H43A662F, affinché lo rappresenti e lo sostituisca per la stipula del contratto di acquisto o del preliminare di acquisto di azioni fino al numero massimo di n° 96750 (novantaseimilasettecentocinquanta) azioni del valore nominale di Leke 1.000 (mille) che rappresenta il 45% del capitale sociale della società albanese Telenorba Shqiptare con sede in Tirana Albania a Rruga Ismail Temali, 27 con registrazione Tribunale di Tirana n. 23723 e codice fiscale n. 3708619 Nipt. K017110041 con capitale sociale interamente versato di leke 215.000.000 in tutte le sedi opportune ed in atti. All'uopo, il sottoscritto Legale Rappresentante conferisce al suindicato procuratore speciale i piu' ampi poteri per la definizione della suddetta operazione, ivi compreso di sottoscrivere gli atti relativi, e quant'altro necessario ritenendo sin da ora per rato e valido il suo operato.

Luca Montrone






545/2006

PROCURA DELLA REPUBBLICA - BARI

Visto, per la legalizzazione del Ministero di Grazia e Giustizia della firma del Sig. Francesco Rebola

Notaio in Bari

apposta sul presente atto da valere all'estero,

Bari, 6 DIC. 2006

IL PROCURATORE DELLA REPUBBLICA

PROCURA DELLA REPUBBLICA BARI

IL PROCURATORE DELLA REPUBBLICA AGG.
Giuseppe CARABBA

**INFOPLUS HOLDINGS LIMITED**
Georgiou Akropoliti 22A, Strovolos, Nicosia, CYPRUS

# RESOLUTION OF THE BOARD OF DIRECTORS
on the 23th November 2006

The undersigned:

1. Mrs. **Eleni Georgiou Parouti**, President of the Board,
2. Mr. **Soteris Paroutis**, member

being all members of the Board of Directors of the Company, which is shareholder of the «TELENORBA SHQIPTARE» Sh.a., a limited responsibility company, duly organized and incorporated under the laws of Albania, registered within the Commercial Register of the District Court of Tirana with the decision no. 23723, dated on 05.05.2000, holder of the 20% of its capital.

**Whereas,**

The Company is the owner and holder of the 20% of the shares capital of «TELENORBA SHQIPTARE» Sh.a., an Albanian law company with limited responsibility, incorporated within the Commercial Register of the District Court of Tirana, Albania by decision no. 23723, and

**Whereas,**

The Company intends to withdraw from the «TELENORBA SHQIPTARE» Company by selling the 20% of shares owned and held in the capital of «TELENORBA SHQIPTARE». For this purpose will be stipulate the respective contract for the Sale & Purchase of the Shares.

**Whereas,**

Ing Prof. **Eligio Romanazzi**, italian citizen, born in Noci (Ba) Italy, on August the 19th 1944, resident in Bari, via Amendola 172/c, passport n141482B, owner of the 7,5% of Telenorba Shqiptare sha with registered office in Tirana Albania, Doct. **Giovanni D'Alessandro**, Sig. Giovanni D`ALESSANDRO, Italian citizen born at Conversano (BA) Italia, on 12 of March 1942, owner of the 7,5% of Telenorba Shqiptare sha with registered office in Tirana Albania and the **Telenorba Italia Spa**

**INFOPLUS HOLDINGS LTD**

Company with registered office in Conversano (Bari)- Via Pantaleo, 20/A P.I. 00825610728- registered on the Bari law court, here represented by Ing. Luca Montrone owner of the 40% of «Telenorba Shqiptare» sha with registered office in Tirana Albania, having the pre-emption right and any third party are invited to buy the 20% of the Shares in the basic capital of the «TELENORBA SHQIPTARE» Sh.a.,

**Whereas,**

The Company «Infoplus Holding Limited», and the parties interested to buy the shares have already agreed for the terms of the contract for the share transfer in the private non-written agreement, with the following conditions:

- the Buyers who ever he will be, has agree to undertakes the obligation to cover any obligations, debts, and responsibilities in general of the «Infolpus Holding Limited» concerning the «Telenorba Shqiptare» sha and of the members defined in the administrative council by the members of the board of directors Ms Eirini Giatra and Ms Lilia Pantazoni from the day that the Company gained the quality of the shareholder until the day that its shares will be transferred.
- The Buyers renounces to whatever pretensions towards the Company as seller and the members indicated by the administrative council (Ms Eirini Giatra and Ms Lilia Pantazoni) from the date of the signature of the respective contract of share transfer.
- The Price of the transfers the Shares in the favour of the Buyers is decided to be at the value of 1(one) €, (or 120 lek), due to the reason that all the above were agreed. If this particular agreement had not been made, the "Selling Part" would not had consented to this transfer.

**Whereas,**

The representation of the «INFOPLUS HOLDING LIMITED» through the authorization given by these Resolutions is consented by the Articles of Association and the law,
The board of directors,

**RESOLVE:**

1. The transfer of the 20% of the shares in the basic capital of the «TELENORBA SHQIPTARE» Sh.A. owned by the Company in the favor of the potential Buyers, Eligio Romanazzi, Giovanni D'Alessandro e Telenorba Italia Spa, or any third interested party,

**INFOPLUS HOLDINGS LTD**

which will became in the possess of the share transferred with all the right and the obligation deriving by their ownership.

2. The stipulation of the Sale & Purchase of the Shares Contract with the buyer party, in conformity with the Albanian law and in conformity with the terms and the conditions already agreed above.
3. The appointment of Ms. Eris HYSI, attorney at law, bearer of the license no.1612, residing in Tirana, Bl Dëshmorët e Kombit, Twin Towers, no. 2, Ap. 9/1, providing her identity by the passport no. Z 0777869, as the representative of the company during the procedures for the stipulation, signature and notarization of the contract. Ms. Eris HYSI, is entitled to act on behalf of the company as its true and lawful representative of the Seller party with all the signing powers.
4. The appointment of Ms. Eris HYSI as the representative of the company in the Meeting of the Shareholders Assembly of the «TELENORBA SHQIPTARE» whenever when this assembly will take place for discussing and deliberating the agenda for the approval of the share transfer operation and for respective amendments of its Articles of Association, as also for the nomination of the Supervisory Board and other matters as will be notified by the company.

This resolution of the Board of Directors is taken in conformity with the competencies given by the constitutive acts and by the law.

**FOR THE BOARD OF DIRECTORS**

**INFOPLUS HOLDINGS LTD**

**Eleni Georgiou PAROUTI**

**Soteris PAROUTIS**

Signed and sealed this day in my presence by Eleni Georgiou Paroutis and Soteris Paroutis who is/are personally known to me. In testimony whereof I have hereto set my hand and official seal this 23/11/2006

DINA CHARITOU
Certifying Officer Nicosia - Cyprus

INFOPLUS HOLDINGS LIMITED

VENDIM I BORDIT DREJTUES
më 23 Nëntor 2006

Të nënshkruarit:
1. Znj. Eleni Georgiou Parouti, Presidente e Bordit
2. Z. Soteris Paroutis, anëtar

në praninë e të gjithë anëtarëve të Bordit Drejtues të Shoqërisë, e cila është aksionere e "TELENORBA SHQIPTARE" Sh.a., një shoqëri aksionere, e organizuar dhe themeluar sipas së drejtës shqiptare, regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë me vendimin nr. 23723, të datës 05.05.2000, mbajtës i 20% të kapitalit të saj.

Ndërsa,
Shoqëria është poseduese dhe mbajtëse e 20% të aksioneve të shoqërisë së "TELENORBA SHQIPTARE" Sh.a., një shoqëri e së drejtës shqiptare, regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë me vendimin nr. 23723, dhe

Ndërsa,
Shoqëria synon të tërhiqet nga Shoqëria "TELENORBA SHQIPTARE" duke shitur 20% të aksioneve të poseduara dhe mbajtura në kapitalin e "TELENORBA SHQIPTARE". Për këtë qëllin do të hartohet kontrata përkatëse për Shitjen dhe Blerjen e Aksioneve.

Ndërsa,
Inxh. **Prof. Eligio R omanazzi**, qytetar italian, , lindur më Noci (Ba) Itali, më 19 Gusht 1944 dhe rezident në Bari më Rrugën Amendola 172/C, me nr. pasaporte 141482B, posedues i 7,5% të Telenorba Shqiptare sh.a me zyrë të regjistruar në Tiranë Shqipëri, **Z. Giovanni D'Alessandro**, qytetar italian lindur në Conversano (BA) Itali, më 12 Mars 1942 posedues i 7,5% të Telenorba Shqiptare sh.a dhe Telenorba Italia Spa shoqëri me zyrë të regjistruar në Conversano (Bari) – Rruga Pantaleo, 20/A P.I. 008254670728- regjistruar në gjykatën e Barit, përfaqsuar këtu nga Ing. Luca Montrone posedues i 40% të "Telenorba Shqiptare" sh.a. me zyrë të regjistruar në Tiranë Shqipëri, duke pasur të drejtën e parablerjes, si dhe çdo palë e tretë janë të ftuara të blejnë 20% të aksioneve që shoqëria Infoplus Holding Limited zotëron në aksionet e kapitalit themeltar të "TELENORBA SHQIPTARE" Sh.a.,

Ndërsa,
Shoqëria "Infoplus Holdings Limited", dhe palët e interesuara të blejnë aksionet kanë rënë dakort për termat e kontratës për transferimin e aksioneve në marrëveshje private të kryer pa shkrim, me kushtet në vijim:

- Blerësit cilido qoftë ai pre persona të sipërpërmendur, ka rënë dakort të ndërmarrë detyrimet dhe të mbulojë çdo detyrim, debit dhe përgjegjsitë në përgjithësi të "Infoplus Holdings Limited" në lidhje me "Telenorba

Shqiptare" sh.a. dhe të anëtarëve të caktuar në këshillin mbikqyrës nga anëtarët e bordit të drejtues Znj. Eirini Giatra dhe Znj. Lilia Pantazoni nga dita që Shoqëria ka fituar cilësinë e aksionerit deri në ditëb që aksionet e saj do të transferohen.

- Blerësi heq dorë nga çdo pretendim kundrejt shoqëritë që shet aksionet dhe anëtarëve të këshillit mbikqyrës të emëruar prej saj Znj. Eirini Giatra dhe Znj. Lilia Pantazoni që nga dita e nënshkrimit të kontratës së transferimit të aksioneve.
- Çmimi i transferimit të aksioneve në favor të blerësve do të jetë në vlerën 1 (një) Euro ose (120 lek), për arsyet e parashtruara më sipër në këtë vendim. Nëse kjo marrëveshje e veçantë nuk është bërë pala shitëse nuk do të miratojë transferimin.

Ndërsa,
Përfaqësimi i INFOPLUS HOLDING LIMITED nëpërmjet autorizimit të dhënë me këtë vendim lejohet sipas Statutit dhe ligjit,
Bordi i Drejtorëve,

VENDOSI:

1. Transferimin e 20% të aksioneve në kapitalin themeltar të Shoqërisë Telenorba Shqiptare Sh.a. të zotëruara nga Shoqëria në favor të ndonjërit prej blerësve të mundshëm Eligio Romanazzi, Giovanni D'Alessandro apo Telenorba Spa, si dhe çdo personi tjetër të interesuar, e cila do të fitojë zotërimin aksioneve të transferuara me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga pronësia mbi to.
2. Të lidhë kontratën e Shti-Blerjes së aksioneve me palën blerëse në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe në përputhje me termat dhe kushtet e rëna dakort.
3. Të caktojë Znj. Eris Hysi, avokate, mbajtëse e liçensës me nr. 1612 me residencë në Tiranë, Bl. Dëshmorët e Kombit, Kullat Binjake, nr. 2. Ap. 9/1, mbajtëse e pasaportës me nr. Z 0777869 si përfaqësuese të shoqërisë gjatë proçedurave të lidhjes, nënshkrimit dhe noterimit të kontratës. Znj. Eris Hysi ka të gjitha të drejtat për të vepruar në emër dhe për llogari të shoqërisë si përfaqësuese e ligjshme e shitësit dhe me të gjitha të drejtat e nënshkrimit.
4. Të caktojë Znj. Eris Hysi si përfaqësuese e shoqërisë në mbledhjen e Asamblesë së Aksionerëve të Shoqërisë TELENORBA SHQIPTARE kurdo që kjo asamble do të mblidhet për të diskutuar dhe vendosur rendin e ditës mbi miratimin e transferimit të aksioneve dhe ndryshimet përkatëse si dhe për emërimin e Këshillit mbikqyrës dhe për çdo çështje tjetër që i është njoftuar shoqërisë.

Ky vendim i Bordit të Drejtorëve është marrë në përputhje me kompetencat e dhëna nga aktet e themelimit dhe ligji.

PËR BORDIN E DREJTORËVE

Eleni Georgiou

Soteris Paroutis

(nënshkrimet dhe vula)

Nënshkruar dhe vulosur në praninë time nga
Eleni Georgiou dhe Soteris Paroutis
I cili/të cilët janë të njohur personalisht prej meje
Në dëshmi të të/cilëve unë kam vendosur nënshkrimin dhe vulën
Sot më datë 23.11.2006

Dina Charitou
Notere në Nicosia – Qipro

Kjo lëshohet për vërtetimin e nënshkrimit të mësipërm
është nënshkrimi i Znj. Dina Charitou
Zyrtar legalizimesh në Nicosia, i emëruar nga Këshilli i Ministrave
të Republikës së Qipros sipas Ligjit të zyrtarëve të legalizimeve Cap. 39 për të vërtetuar nënshkrimet dhe vulat, dhe se vula në krah dhe nënshkrimi përkatës janë të Zyrtarit të legalizimi të Nikosias.
Zyrtari i Distriktit Nikosia M. Christodoulou
Nikosia – Qipro
Datë, 24.11. 2006

Apostille
Konventa e Hagës e 5 Tetorit 1961
1-Vendi : Qipro
Ky dokument publik
2-është nënshkruar nga M. Christodoulou
3-në cilësinë e tij si Zyrtar i Distriktit
4-mbajtës i vulës dhe pullës i këtij Zyrtari të Distriktit
vërtetuar
5-më Nikosia 6- më datë 24 Nëntor 2006
7-nga M. Iasonos
8-me nr. 204077/06
9-Vulë/Pulla 10-nënshkrimi
Sekretari i Përhershëm i Ministrisë së Drejtësisë dhe Rendit Publik.
(nënshkrimi, pulla dhe vula

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
N. 2689 Rep.

# VERTETIM

Une i neneshkruari, Agim Xh. Robo, noter ne qytetin e Tiranes, Rruga Ismail Qemali, P. 27/1, vertetoj se kam perkthyer sa me siper nga anglishtja ne shqip, njelloj me origjinalin.

Tirane, me 19.03.2007

NOTER
Agim Xh. Robo

PULLE TAKSE
100 LEKE
R.SHQIPERISE

PROCURA SPECIALE

IL sottoscritto Ing. Luca Montrone nato a Conversano (Ba) il 26 Luglio 1939, in qualita' di Presidente e Legale Rappresentante della societa' TELENORBA S.P.A. con sede in Conversano (Ba) alla Via

Pantaleo 20/A

NOMINA E COSTITUISCE

suo procuratore speciale l'Ing. Eligio Romanazzi, nato a Noci (Ba) il 19 Agosto 1944 e residente a Bari in Via Amendola 172/C, codice fiscale RMNLGE44M19F915H, affinché lo rappresenti nell'assemblea ordinaria e straordinaria della societa' albanese Telenorba Shqiptare con sede in Tirana Albania a Rruga Ismail Temali, 27 con registrazione Tribunale di Tirana n.23723 e codice fiscale n. 3708619 Nipt. K017110041 con capitale sociale interamente versato di leke 215.000.000, che si terrà in data 27-12-2006 alle ore 9,00 presso la sede sociale della società in 1° convocazione e in data 28-12-2006 in 2° convocazione stessa ora e luogo per deliberare sul seguente ordine del giorno:

TELENORBA S.p.A.
Il Presidente
(Ing. Luca Montrone)

Per assemblea straordinaria:

1) Vendita azioni
2) Varie ed eventuali;

Per assemblea ordinaria:

1) Nomina dei nuovi membri del Consiglio di Supervisione.

All'uopo, il sottoscritto Legale Rappresentante conferisce al suindicato procuratore speciale i piu' ampi poteri per la definizione della suddetta operazione, ritenendo sin da ora per rato e valido il suo operato.

**TELENORBA S.p.A.**
**Il Presidente**
***(Ing. Luca Montrone)***

Repertorio n. 515391

AUTENTICAZIONE DI SOTTOSCRIZIONE

REPUBBLICA ITALIANA

Io sottoscritto dottor Francesco REBOLI, Notaio in Bari, iscritto nel Collegio del Distretto Notarile di Bari,

certifico che ha firmato oggi in mia presenza l'atto che precede, l'Ingegner

MONTRONE Luca, nato a Conversano (Ba) il giorno ventisei luglio 1939,

in qualità di Presidente e Legale Rappresentante della società " TELENORBA S.p.A. ", con sede in Conversano (Ba), alla Via Pantaleo, civico 20,

capitale sociale, interamente versato, Euro duemilionitrecentoquarantamila (Euro 2.340.000,00),

codice fiscale, ed iscrizione nel Registro delle Imprese di Bari, numero 00825610728,

ove domicilia per la carica,

della cui identità personale, qualifica e poteri, io notaio sono certo.

Bari, dodici dicembre duemilasei, nel mio studio, alla Via Putignani, civico 12/A.

PROKURË SPECIALE

I nënshkruari inxh. Luca Montrone lindur në Conversano (Ba) më 26 Qershor 1939, në cilësinë e Presidentit dhe Përfaqsuesit Ligjor të shoqërisë 'TELENORBA S.P.A. me seli në Conversano (Ba)
